



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 46 (827798)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 nëntor 2022

“Krenari kombëtare, të ngresh lart flamurin shqiptar”

Sporti i qitjes ka qenë e vazhdon të mbetet një nga krenaritë e sportit shqiptar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Është një nga sportet më elitare në vend, nga i cili kanë dalë disa kampionë Europe, dhjetëra kampionë Ballkani, që janë kthyer me një numër të jashtëzakonshëm medaljesh. Qitja numëron një numër të madh “Mjeshtresh të merituar të sportit”,

si Ali Mata, Ismail Rama, Skënder Mata, Sadik Kuçana, Shefqet Mata, Beqir Kosova, Diana Mata, Elisabeta Karabolli, Ermira Dingu, Kristo Robo, Niko Shtrepi, Emanuela Kola etj. Por për të gjithë ata që ndjekin sportin, dhe sidomos sportin e qitjes, nuk ka se si të mos kenë dëgjuar për familjen Mata, e cila si rrallë herë ndodh që një familje të bëhet simbol i qitjes shqiptare,

pasi i ka dhënë këtij sporti 6 sportistë, të cilët kanë shënuar suksese në rrugëtimin e tyre. Një familje e lidhur fort me sportin e qitjes, “një dinasti dominuese mbi 60-vjeçare, në këtë lloj sporti, që për të qenë fitues duhet të qëllosh në zemër të 10-tës”. Një prej tre emrave më të spikatur të familjes Mata është Marjana, qitësja e talentuar e palodhur... >> faqe 6-7



Marrëveshja G2G II, Shqipëri - Maqedoni e Veriut

Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, vizitë në Forcën Detare

Në përmbushje të programit mësimor të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm për vitin akademik 2022-2023, nën drejtimin e Departamentit të Udhëheqjes Ushtarake të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kursantët e KKSHP zhvilluan një vizitë njohëse në Komandën e Forcës Detare në Durrës. Kursantët dhe stafi pedagogjik u pritën nga drejtues të Komandës së Forcës Detare, të cilët pasi i uruan mirëseardhjen në Komandë i njohën kursantët me...



Faqe 2

Fidanishtja Ushtarake, oazë e njerëzve ‘të mëdhenj’

Skënder Sulku, një nga drejtuesit e Flotës Ushtarake Detare Shqiptare, është lindur, më 15 janar të vitit 1929, në Gollobordë të Dibrës. Rrjedh nga një familje e varfër fshatare por me tradita të njohura atdhetare e patriotike dhe pjesëmarrëse aktive në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ka marrë pjesë vetë në luftën për çlirimin nga okupatori, duke qenë i inkuadruar në Brigadën e IV Sulmuese. Ai është ndër nxënësit e parë të zonës që iu dha e drejta për të filluar...



Faqe 4

Gjuha shqipe, amaneti i të parëve, simbol i identitetit kombëtar

Kongresi i Manastirit nuk ishte vetëm kongres për gjuhën shqipe po pararendës i një kompozimi idesh gjithëpërfshirëse për çështjen e kombëtare. Ky kongres i madh për shqiptarët erdhi si thirrje e iniciativë e klubit “Bashkimi”, dhe e dëshirës për unifikimin e gjuhës shqipe që në atë kohë ishte në disa versione. Kongresi pati përfaqësuesit më të shquar dhe atdhetarët e nacionalistët më të flaktë të Shqipërisë si: Gjergj Fishtën, Mithat Frashërin, Ndre Mjedën, Shahin Kolonjën, Bajo Topullin, Parashqevvi Qirjazin etj...



Faqe 10-11

Në përmbushje të programit mësimor të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm për vitin akademik 2022-2023, nën drejtimin e Departamentit të Udhëheqjes Ushtarake të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kursantët e KKSHP zhvilluan një vizitë njohëse në Komandën e Forcës Detare në Durrës.

Kursantët dhe stafi pedagogjik u pritën nga drejtues të Komandës së Forcës Detare, të cilët pasi i uruan mirëseardhjen në Komandë i njohën kursantët me strukturën, organizimin, misionin dhe detyrat që kryen FD. Në përfundim të prezantimit u tregua mjaft interes nga kursantët, të cilët adresuan pyetje dhe diskutuan mbi çështje aktuale që përballen Forca Detare dhe objektivat e saj në të ardhmen. Kjo vizitë u mbyll me foto të përbashkët.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, vizitë në Forcën Detare



“Kush dhuron gjak, shpëton jetë”



Në Bunavi organizohet dita e dhurimit të gjakut. Në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, pas një fushate sensibilizuese, më datën 15.11.2022 u organizua dita e dhurimit të gjakut. Personeli mjekësor i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, zhvilloi procedurën nën masa rigorozë për mbrojtjen e shëndetit të dhuruesve të gjakut. Me moton: “Kush dhuron gjak, shpëton jetë”, 15 efektiva dhe personel i kësaj qendre dhuruan gjak për njerëzit në nevojë.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Marrëveshje G2G II, Shqipëri - Maqedoni e Veriut

Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes

Qeveria shqiptare dhe ajo e Maqedonisë së Veriut mbajtën në Shkup një mbledhje të përbashkët, nga e cila u arritën memorandum të rëndësishëm.

Të dyja vendet e kanë hapur procesin e negociatave të vendit kandidat të BE-së, duke hedhur një hap shumë të madh përpara.

Tirana zyrtare, më 6 dhjetor, do të mbajë samitin e BE-së me Ballkanin Perëndimor. Në këtë mbledhje të përbashkët ministrat e dy qeverive nënshkruan 21 dokumente, marrëveshje dhe memorandume, të cilat i referohen bashkëpunimit në fushën e procesit të integritimit evropian, mbrojtjes, sigurisë, infrastrukturës, energjisë, kulturës, luftës kundër krimit ndërkombëtar, lidhjes hekurudhore të dy vendeve, standardizimit të shërbimeve në fushën e teknologjisë digjitale, transportit ujor ndërkombëtar në liqenin e Ohrit, për bashkëpunim në fushën e financave publike, zhvillimin e sipërmarrjes dhe të tjera.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, nënshkroi me homologen Sllavjanka Petrovska, Memorandumin e Mirëkuptimit.

“Një mundësi për të intensifikuar bashkëpunimin, si një përgjigje për situatën delikate të krijuar në Europë.


Stërvitje të përbashkëta, trajnim i personelit ushtarak dhe civil, bashkëpunim në fusha si inteligjenca / zbulimi apo edhe mbrojtja kibernetike, mundësohen nga ky memorandum”, - do të shprehej ministri Peleshi në përfundim të këtij takimi.



Vizitë kortezie e atasheut ushtarak të Turqisë, kolonel M. Kelami Kablay me komandantin e AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri priti atasheun ushtarak të Turqisë kolonel M. Kelami Kablay në një takim kortezie. Atasheu uroi komandantin e AFA-së për detyrën e re dhe ishte besimplotë në rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit me Akademinë e Forcave të Armatosura.

Komandanti i AFA-së vlerësoi mbështetjen e Turqisë në fushën e edukimit, theksoi faktin se mbi 300 studentë kanë përfunduar studimet në Akademitë Ushtarake Turke. Komandantin i AFA-së së bashku me atasheun ushtarak të Turqisë vlerësuan bashkëpunimin ushtarak të deritanishëm dhe u shprehën për rëndësinë e vijimit të bashkëpunimit në të ardhmen.





Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në vendin tonë dhe ai i Republikës së Kosovës, vizitë në batalionin e Tretë të Këmbësorisë



Shërbimi i asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve (EOD) është një kapacitet kombëtar mbështetës, që redukton dhe eliminon rrezikun që vjen nga municionet dhe eksplozivët që kërcënojnë personelin, instalimet ushtarake, popullsinë e pronën, si brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE dhe OKB-së. Ambicia është krijimi i Qendrës së Ekselencës për EOD dhe Armatim-Municionin për të gjithë rajonin, nëpërmjet zhvillimit të kurseve të të gjitha niveleve, me ndihmën dhe bashkëpunimin e partnerëve tanë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontingjente të EOD-së, prej vitesh kanë dhënë kontribut në misione të ndryshme ndërkombe-tare dhe aktualisht janë pjesë e misionit të NATO-s “Enhanced Forward Presence” në Letoni. Ata janë në krye të detyrës kudo ku i thërret nevoja.



Bashkëpunimi i shkëlqyer i Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale me ushtrinë britanike, vijon të thellohet nëpërmjet stërvitjes dypalëshe “Strong Eagle 5”.



Oficerët e rinj, që po ndjekin Kursin Bazë të Oficerit (KBO) në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, testuan njohuritë e tyre në topografi, nëpërmjet zhvillimit të marshimeve orientuese me dhe pa hartë.



FIDANISHTJA USHTARAKE, OAZË E NJERËZVE 'TË MËDHENJ'

Skënderbegasi Skënder Sulku, mjeshtër i pikturës dhe ushtaraku i njohur i detarisë shqiptare

Skënder Sulku, një nga drejtuesit e Flotës Ushtarake Detare Shqiptare, është lindur, më 15 janar të vitit 1929, në Gollobordë të Dibrës. Rrjedh nga një familje e varfër fshatare por me tradita të njohura atdhetare e patriotike dhe pjesëmarrëse aktive në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ka marrë pjesë vetë në luftën për çlirimin nga okupatori, duke qenë i inkuadruar në Brigadën e IV Sulmuese.

Ai është ndër nxënësit e parë të zonës që iu dha e drejta për të filluar studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", dhe njëkohësisht ndër 20 studentët e parë shqiptarë që u dërguan jashtë vendit për t'u kualifikuar si ushtarakë karriere. Menjëherë pas çlirimit të vendit, ai dërgohet për studime ushtarake në Split të Jugosllavisë, një nga vendet tona fqinje dhe aleat i kauzës së përbashkët për të cilën u bë dhe lufta. Por prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë, bën që Skënderi së bashku me studentët e tjerë ushtarakë të ndërpresin përkohësisht studimet dhe të kthehet në atdhe. Por menjëherë, ai nis për të vazhduar e përfunduar studimet e nisura në Baku të Azerbaxhanit të BRSS, përkatësisht në Akademinë e Flotës Detare. Përfundon shkollimin me rezultate të mira e kthehet në atdhe. Emërohet në Bazën Detare të Pashalimanit në Vlorë si specialist i silurëve. Këtu, me aftësitë profesionale dhe përkushtimin në punë, ai shfaq talentin duke merituar vlerësimin e eprorëve të tij. Kështu, ushtaraku detar dibran, nis për një shkollim 4-vjeçar në Leningrad të Rusisë. Rikthehet përsëri pas studimeve në detyrën e vështirë por të bukur të detarisë nënujore. Karriera e tij si nënujës e më pas në linjën politike të kohës ishte një karrierë e pasur dhe me rezultate. Këto vlerësime të karrierës së gjatë janë shprehur në një sërë mirënjohjesh urdhrash e medaljesh të akorduara nga strukturat politike e shtetërore të kohës.

Dalja në pension pas 25 vjetësh karriere në ushtri, për Skënderin ishte fillimi i një karriere të re, që ishte e lidhur me pasionin e tij të hershëm për pikturën. Peizazhi, natyra e qetë e portreti kanë mbizotëruar në punët e tij të cilat janë afishuar krahas të tjerave në tri ekspozita të mëdha në Tiranë e shumë të tjera në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Ekspozita "Motive nga deti" u shoqërua nga ai vetë në të gjitha repartet ushtarake detare të Republikës. Pas ngjarjeve në Kosovë ai krijoi një ekspozitë me mbi 100 punime titulluar "Historia e popullit kosovar", të cilat i ekspozoi në Itali, Gjermani e në disa vende të tjera. Mjaft nga veprat e tij kanë tematikën e historisë kombëtare, dëshmorëve të luftës, njeriut të thjeshtë etj... Piktura dhe krijimtaria nuk njeh moshë. Ai vazhdoi të punojë me përkushtim e pasion si piktor e artist i talentuar. Skënder Sulku, me gjuhën e pikturës vazhdoi t'u transmetojë



brezave të rinj dashurinë për atdheun deri në ditën e fundit të jetës së tij.

Ja çfarë shkruan shkrimtari Sh. Topollaj për Skënder Sulkun: "Për dhjetë vjet me radhë, Skënder Sulku

si autodidakt dhe duke konkurruar në Azerbejxhan me tablonë "Bukurshja e Kaspikut", fitoi çmimin e parë. Kur u kthye në Shqipëri, jeta intensive në Flotën Luftarake, e pengoi për t'u marrë

ato në telajo. Natyrisht që impresione të veçanta i la lufta e Kosovës, barbaria serbe ndaj popullit të saj dhe qëndresa burrërore e luftëtarëve trima të UÇK-së. Duke e parë kështu krijimtarinë e

"Tragedia Kosovare", është pritur aq ngrohtësisht dhe është vlerësuar shumë lart nga një mori personalitetesh, deri sa një kritik i njohur italian e ka quajtur atë "Një lëvizje arti si një histori". Piktura plot ngjyra e dritë e Skënderit, është pikturë që i bindet më shumë vullleve shpirtërore. Si e tillë ajo depërton thellë në shpirtat e të gjithë atyre që e sodisin. Mesazhet atdhetare e edukative që ato mbartin, gjetet patetike të figurave, kompozimet konvulsive dhe teknika e të pikturuarit plot jetë, i bën pikturat e Skënder Sulkut shumë njerëzore e të kuptueshme në thjeshtësinë e mençurinë e tyre". Mjaft nga veprat e Skënder Sulkut sot ndodhen në Galerinë e Arteve, në muze, biblioteka e salla të ndryshme. Ata të kujtojnë jo vetëm mesazhe të gjalla të një jete të gjallë e dinamike, një art me mesazhe kuptimplote e jetësore, por dhe autorin që një jetë ia përkushtoi punës, përkushtimit si oficer i Detarisë dhe piktor. Babai i tre fëmijëve, shumë nipërve e mbesave, mbylli sytë më 7 janar 2009, në Tiranë.

Kujtim Borici, Maksim Fejzullai

studioi për armatim e nëndetëse, në Jugosllavi dhe në shkollat ushtarake në Baku, San Peterburg e Sevastopol të ish-Bashkimit Sovjetik, por asnjëherë nuk e harroi pasionin ku e çonte talenti i tij. Vizitonte galeritë e famshme, deri Ermitazhin dhe admironte e mësonte nga kryemjeshtrit e pikturës botërore dhe sidomos asaj ruse. Punoi sa mundi

seriozisht me pikturë. Por kur doli në pension, në vitin 1973, mori vendimin fisnik që të kompensonte vitet e humbura në artet figurative. Duke i qëndruar besnik rrugës së traditës të piktorëve tanë më të shquar, ai me formimin e tij qytetar, parapëlqeu temën historike. Vetë kishte përjetuar shumë ngjarje të rëndësishme, ndaj donte t'i përjetësonte

Skënder Sulkut, dhe mundimin e tij për ta çuar pikturën patriotike tek populli, sikurse ka bërë në Kosovë, ku e ka çelur ekspozitën e tij në dymbëdhjetë qytetet kryesore, pa frikë mund ta quajmë atë "Luftëtar i lirisë në art", duke huazuar fjalët që Ilia Rjepini tha për Ezhen Delakruanë. "Ne duhet të ndjehemi krenarë që ekspozita e tij e quajtur

● *Dalja në pension pas 25 vjetësh karriere në ushtri, për Skënderin ishte fillimi i një karriere të re, që ishte e lidhur me pasionin e tij të hershëm për pikturën. Peizazhi, natyra e qetë e portreti kanë mbizotëruar në punët e tij, të cilat janë afishuar krahas të tjerave në tri ekspozita të mëdha në Tiranë e shumë të tjera në rrethe të ndryshme të Shqipërisë.*

INTERVISTË ME ZNJ. MARJANA MATA, REKORDMENE NË SPORTIN E QITJES

"Krenari kombëtare, të ngrësh lart flamurin shqiptar"

"Ambicia ime, të vazhdoj të jem në treshen e republikës"

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Sporti i qitjes ka qenë e vazhdon të mbetet një nga krenaritë e sportit shqiptar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Është një nga sportet më elitare në vend, nga i cili kanë dalë disa kampionë Europe, dhjetëra kampionë Ballkani, që janë kthyer me një numër të jashtëzakonshëm medaljesh. Qitja numëron një numër të madh "Mjeshtërash të merituar të sportit", si Ali Mata, Ismail Rama, Skënder Mata, Sadik Kuçana, Shefqet Mata, Beqir Kosova, Diana Mata, Elisabeta Karabollit, Ermira Dingu, Kristo Robo, Niko Shtrepi, Emanuela Kola etj.

Por për të gjithë ata që ndjekin sportin, dhe sidomos sportin e qitjes, nuk ka se si të mos kenë dëgjuar për familjen Mata, e cila si rrallë herë ndodh që një familje të bëhet simbol i qitjes shqiptare, pasi i ka dhënë këtij sporti 6 sportistë, të cilët kanë shënuar suksese në rrugëtimin e tyre. Një familje e lidhur fort me sportin e qitjes, "një dinasti dominuese mbi 60-vjeçare, në këtë lloj sporti, që për të qenë fitues duhet të qëllosh në zemër të 10-tës".

Një prej tre emrave më të spikatur të familjes Mata është Marjana, qitëseja e talentuar e palodhur dhe me vullnet të fortë, e cila gjatë rrugëtimin të saj 46-vjeçar ka fituar 2 herë medalje ari krahas medaljeve të argjendit dhe shumë diplomave dhe certifikatave të tjera. Ajo bën pjesë në stafin e QKMBMM të Forcave të Armatosura dhe na sjell nëpërmjet intervistës përvojën dhe arritjet e saj.

Znj. Marjana Mata, mirë se erdhët në shtypin ushtarak. Ju jeni një qitëse e talentuar, një rekordmene, që keni grumbulluar shumë përvojë gjatë viteve në këtë sport të veçantë dhe të bukur, siç është qitja. Si u përfshitë?

E kam filluar sportin e qitjes në moshën 16-vjeçare e pak më tepër, moshë që përkon edhe me fejesën time, dhe që nga ajo kohë e deri më sot, që jam 62 vjeç nuk jam shkëputur asnjëherë nga ky sport. Burri im ishte sportist, ai ishte rekordmen në qitje, edhe vjehri im, Ali Mata. E gjithë familja Mata ishte e lidhur me këtë sport. Ju duhet të keni dëgjuar për ta, për Aliun, Nerin, (Skënder Matën, bashkëshortin) "Mjeshtër i Sportit", Diana Mata, "Mjeshtre e Sportit", gjithashtu. Që të gjithë ata e donin shumë këtë sport. Ju më pyetët se si jam përfshirë edhe unë, po ua tregoj. Një ditë, vjehri im, Ali Mata që ishte edhe trajner ndërkombëtar, më thotë të shkoj me ta në poligon, ku stërviteshin Neri, Diana, Elisabeta Karabollit dhe shumë të tjerë sportistë të ekipit të qitjes. Teksa i pashë ata në poligon të pozicionuar më përleu shumë, më tërhoqi shumë stërvitje e tyre dhe vjehri im, Aliu, që mesa duket e vuri re këtë gjë, më tha që ta provoja dhe unë. U futa në vendin ku stërviten sportistët dhe realizojnë qitjen. U pozicionova, morra pistoletën, shtriva kra-hun, pashë tabelën, pashë 10-tën, që në fakt 10-ta në tabelë mu duk shumë e madhe atëherë, dhe nga 30 fishekët që kam shtënë atë ditë, 26 i futa tek 10-ta dhe 4 fishekët e tjerë tek 9-ta. Ishte emocionuese dhe e habitshme njëkohësisht. Atëherë vjehri im, që ishte edhe trajner, më tha: "Hajde që nesër, do të stërvitesh me të tjerët!". Dhe që atëherë e deri më sot kam 46 vjet në qitje, 46 vjet në poligon, që nuk jam shkëputur nga ky sport, as edhe një ditë, asnjëherë. Është bërë jeta ime. Pastaj kanë qenë edhe pritshmëritë të cilat na kanë udhëhequr në punën tonë si sportistë që nuk të lejojnë të ndalesh.

Ishte rastësi që shënuat tek 10-ta që herën e parë, apo çfarë?

Po. Mendoj se ishte rastësi. Ishte tepër emocionuese. U emocionova, ishin të gjithë njerëzit e familjes time atje dhe ajo që ndodhi me mua ishte thjesht një rastësi. Kështu e mendoj edhe tani kur kujtoj se sa punë dhe djersë duhet të derdhësh për të pasur sukses dhe për të dalë në krye. Nëse atëherë në qitjen me zjarr bënim prova në 30 garë precizion dhe 30 garë shpejtësi, sigurisht që duhej stërvitje e madhe. Qitjen time të parë e bëra me tabelë të hapur për 3 sekonda, në siluetë, dhe unë shkëlqeva atë ditë. Që atëherë precizionin e kam timin, 30 precizion, 30 siluetë. Jam një nga tre pjesëtarët e familjes Mata që kemi shkëlqyer në atë periudhë.

Pra Ali Mata, të cilin ju keni pasur fatin ta kishit vjehërr, ka zbuluar talentin tuaj si një qitëse e së ardhmes. Por për të vazhduar duhej punë dhe stërvitje e përditshme. Si ecët më tej, kush ka qenë trajneri juaj i parë?

Po sigurisht, për të ushtruar këtë sport, ashtu si dhe shumë sporte të tjera, nuk mjafton vetëm talenti.



Të gjitha llojet e sporteve kërkojnë shumë stërvitje, kërkojnë shumë djersë, shumë orë në poligon, që do të thotë përqendrim, vëmendje dhe shumë vullnet. Por të kthehem tek pyetja juaj, trajneri im i parë ka qenë Ali Mata, pasi ai më tregoi këtë rrugë kaq të bukur, ai zbuloi talentin tim dhe bëri që unë të ec në gjurmët e familjes së nderuar Mata, që shkëlqen si një xhevahir i rrallë në mozaikun e madh të sporteve tona. Pastaj trajnerja ime ka qenë Elisabeta Karabollit. Me Beta Karabollin, e them me krenari por njëkohësisht edhe me shumë modesti, kam shkëlqyer. Atje kam shkëlqyer, pasi më janë shpërblyer të gjitha orët e stërvitjes dhe të lodhjes. Kurse aktualisht unë kam trajneren e palodhur, Shpresa Kotri "Mjeshtre e Sportit", e cila me përkrahimin që ka ndaj nesh, gjen momentin për të na koordinuar dhe stërvitur ne si ekip prej 15 sportistësh, pushkë dhe pistoletë.

Cilat kanë qenë rezultatet tuaja më konkrete?

Gjatë një viti zhvillohen 8 deri në 10 gara sportive në qitje dhe sportisti sigurisht ka ngritjet dhe uljet e veta gjatë këtyre garave, por që gjithmonë një qitës i mirë qëndron lart në vendet e para të klasifikimit. Rezultatet e garave të mia kanë qenë të tilla që më kanë mbajtur gjithmonë në treshen, pra duke u klasifikuar në tre vendet e para. Kështu që para viteve 1990 unë jam klasifikuar duke mbajtur 9 vende të para, 4 vende të dyta dhe 8 vende të treta.

Në viti 1983 ne u shpallëm Kampion Ballkani me ekipin e të rriturve në garën e të rriturve, ku unë isha pjesë edhe atje kam qenë në treshen më të mirë. Kurse në vitin 1984, u klasifikova e para, por edhe kam thyer rekordin kombëtar me 586 pikë, rekord të cilin e mbaj edhe sot, pasi nuk është thyer ende. Në vitin 1985 në ushtrimin standard kalova direkt në ekipin e parë të "17 Nëntorit", në kategorinë A. Ky vit shënon për mua edhe "Rekordin e Dyshes", Diana - Marjana, rekord që mbahet edhe sot nga ne, me 1169 pikë dhe 1171 pikë.

Edhe pas viteve '90 vazhdoj të jem në treshen e

një pistoletë në mënyrë korrekte, ta çmontojnë dhe montojnë atë, të kryejnë një numër veprimesh. Gjatë trajnimit, aftësitë përmirësohen dhe njohuritë konsolidohen. Falë përsëritjes të veprimeve, një person fillon të kuptojë se si funksionojnë armët dhe ai ka teknikën e tij të veçantë. Qitësi e kupton se çfarë është trajnimi, mësimi dhe konceptet e tjera, mëson se si funksionon arma, pastaj arrin të kuptosh se sa e rrezikshme mund të jetë një armë. Faza tjetër është gjuajtja, përpqesh të bësh një gjuajtje, dhe më pas të ngrësh aftësinë nëpërmjet përsëritjeve të shumta. Trajnerët për këtë sport së pari të japin njohuri teorike, pastaj tregojnë se si të gjuash dhe vetëm atëherë të ofrojnë të përdorësh një armë dhe të përpqesh të godasësh në tabelë. Duke qenë në fillim përballesh edhe me frikën se mund të bësh gabime, por trajneri të mbështet dhe është atje me ty të të shpjegojë se stresi nuk të ndihmon dhe nuk të lejon të përqendrohesh në objektiv.

Sa zgjat një garë qitjeje, si është të përqendrohesh?

Gara e ajrit zgjat 1,5 orë pa ndërprerje, por sportisti mund ta kryejë atë edhe për një kohë më të shkurtër. Unë e realizoj në më pak se 1.5 orë. Vendosesh në pozicion dhe pasi bën provën realizon qitjen. Por ka raste që në momentin që je gati dhe e pozicionuar mund të ndodhë që sportisti të ketë probleme dhe të tërhiqet, pushon dhe më pas mund të rifillojë.

Juve ju ka ndodhur?

Po sigurisht, edhe mua më ka ndodhur kjo gjë. Jam tërhequr pas, kam pushuar 5 minuta dhe jam futur sërish për të vazhduar garën. 15 minuta është koha, pas së cilës ti do t'i fusësh saçmat në tabelë. Pra pozicionohesh, shtrin kra-hun dhe krijon një vijë drejtvizore imagjinare tabelë-pistoletë. Do bësh provën 15 minuta dhe pas kësaj fillon gara, që zgjat 1 orë e gjysmë. Që në momentin që ndjehesh gati, ti vazhdon garën, por ama kur sheh që ti nuk je mirë duhet të tërhiqesh, të qetësohesh. Janë 60 saçma që ti duhet t'i fusësh në qendër, por ama 15 minuta është prova me detyrim. Pa provë nuk mund të fillosh.

Po ju tregoj diçka që më ka ndodhur, edhe pse vetëm një herë gjatë gjithë jetës time sportive, por është diçka të cilën nuk e harroj. Më ndodhi që mora 4, vetëm një herë, por ja që shënova 4 pikë. E pafalshme për mua, a e di se çdo të thotë të ulesh 6 pikë menjëherë? E dhimbshme për një qitës, por ja që ndodhi. Pas 46 vjetësh qitje, stërvitje, gara, rekorde, medalje ari, argjendi, më ndodhi që të gaboja. Mora 4, pra humba 6 pikë dhe fitova vetëm 4. U tërhoqa, qëndrova të qetësohesha 5 minuta, e mblodha veten, gjendja psikologjike për një qitës do të thotë shumë. E rëndësishme është të mbledhësh veten dhe të fillosh prapë. Pastaj u përqendrova njëqind për qind. Ne kemi kufje në vesh dhe shohim vetëm përpara gjatë qitjes. Trajneri qëndron prapa sportistit duke monitoruar çdo problem që mund të dalë gjatë garës dhe ti si qitës nuk

qitëseve më të mira, ku jam klasifikuar 10 herë në vend të parë, 12 herë në vend të dytë dhe 25 herë në vend të tretë.

Si është të stërvitesh në poligonin e qitjes?

Sporti i qitjes është një sport si gjithë të tjerët, që në thelb ka garën, por ai gjithashtu ka të veçantën e tij të bukur, ku konkurrentët garojnë në saktësinë e gjuajtjes. Armët që përdor sportisti në këtë rast janë ato të zjarrit dhe pneumatike, prandaj dhe qitja praktike konsiderohet një sport i veçantë. Por theksoj se gjatë gjithë ekzistencës së disiplinave të ndryshme në sportet e qitjes, nuk ka pasur asnjë aksident të vetëm, që të shoqërohet me armë zjarri. Sot ajo zhvillohet me pistoletë pneumatike. Megjithatë sporti i qitjes konsiderohet një sport i sigurt. Qitësit mësojnë se si të mbajnë





duhet të lëvizësh nga pozicioni. Qitja kërkon përçendrim të shikosh vetëm përpara. Asnjëherë prapa. Në ato çaste asgjë nuk ekziston prapa apo anash për ty. Nuk duhet të lëvizësh nga pozicioni, pasi kjo ndikon në rezultat.

Karriera juaj në sportin e qitjes është e gjatë, kur mendoni se do të ishte momenti për të bërë një hap prapa për t'u tërhequr, me qëllim për t'ju lënë vendin të rinjve?

Sporti i qitjes nuk ka moshë, por dhe çdo sport ka rregulloren e vet. Puna është në ekip dhe forma ime sportive i rrit pikët e ekipit, pasi mblidhen pikët në këtë sport. Nga 40 pjesëmarrës (pushkë dhe pistoletë) që janë sot, radhitem e 4-ta. Kam marrë edhe vende të para edhe të dyta pasi zhvillohen 8-10 gara në vit. Jam në sfidë dhe në garë me veten për të marrë pikët e duhura. Kam egon time profesionale që të arrij qëllimet që i kam vënë vetes. Dua të jem në dymbëdhjetëshen më të mirë të vitit dhe për këtë ka shumë garë dhe shumë konkurrencë, pasi pas 46 vjetësh, aktualisht nuk jam pjesë në të. Është vetëm një përqindje e vogël që më pengon dhe që dua ta arrij. Unë jam e katërta dhe

më e vjetra e qitjes nga të gjithë ekipet, 5-6 ekipet që ka vendi sot. Të rinjtë sot duhet të provojnë në vijën e zjarrit. Në qitje futesh që në moshë të re. Janë grupmosha të caktuara për të rinjtë dhe nëse ata paraqiten mirë kalojnë në grupin e të rriturve, ku jam unë sot.

Ky është një pasion, është kthyer në një pasion të cilin unë nuk e le dot. Në fillim lindi si një kuriozitet i moshës, por prova e parë më bëri që ta doja fort dhe që t'i përkushtohem. Por nga ana tjetër po nuk pate ego dhe këmbëngulje mendoj se dështon. Sporti është individual dhe kërkon disiplinë në stërvitje, sa më shumë stërvitje aq më shumë rezultate.

Cilat janë objektivat tuaja në këtë stad ku jeni sot?

Siç e thashë më lart vetëm qitja që s'ka moshë dhe objektivi im është të mos ndahem nga treshja. Dua të qëndroj në treshje edhe në një pesëvjeçar, ky është objektivi im, prandaj nuk jam gati për ta lënë sportin në këto momente. Në çdo aktivitet garoj për të marrë diplomë në treshje. Kjo është ambicia ime, treshja, që do të thotë që me stërvitjen dhe këmbënguljen time të jem në treshen e Republikës edhe për 5 vjet. Pastaj do



të tërhiqem. Treshja më është bërë pjesë e jetës. Pa të nuk marr dot frymë. Deri sa unë të jem në treshje nuk do të iki. Kam shkëlqyer në vende të para. Kam pasur ulje ngritje dhe janë dhjetë vitet e fundit që nuk dal nga treshja. Po ama nga ana tjetër po nuk bëre stërvitje gjithçka është kot. I mbaj figurat, edhe ato që i kam pasur prej vitesh. Pas stërvitjes gjithmonë i marr në shtëpi figurat dhe shoh me qetësi ku kam gabuar, për ta korigjuar të nesërmen. Unë jam në vijë të zjarrit dhe gara është garë, do të tërhiqem vetëm kur të arrij objektivin tim. Çdo sport ka rregulloren e vet dhe ky sport ka këtë rregull, ti del nga sporti kur ke humbur, pra kur dikush tjetër është më i mirë se ty dhe të ka mundur.

Po në gara të tjera jashtë vendit, ku keni qenë?

Kam qenë në Kosovë, ku kam dalë mirë, kam shkëlqyer me precizion që në garën e parë. Në garat në Kosovë, gjithashtu kam marrë vende të para dhe medalje. Kemi shkëlqyer së bashku me ekipin. Është krenari kombëtare, të ngresh lart flamurin shqiptar, kudo ku garon. Në moshë kam qenë e re, por sipas arritjeve kam qenë në ekip me të rriturat. Edhe nga ato vite kam disa figura që i mbaj ende si kujtim, pasi kam dalë shkëlqyer në ato qitje. E them me nostalgji, modesti por dhe me krenari. Pas 3 vjetësh rresht, ku isha kampione e qitjes me ajër, pneumatike, federata jonë më dha pistoletën e ajrit, "Pardini", të cilën dua ta mbaj sa më denjësisht edhe sot.

Si janë kushtet e poligoneve të ne, ku stërviteni ju?

Deri në vitin 1991, qitja numëronte 31 ekipe me 1500 sportistë, në dispozicion të tyre ishin 25 poligone, kishte ekipe të kategorisë së parë dhe të dytë, që ishin në të gjithë Shqipërinë. Kanë qenë 154 trajnerë të kategorizuar, një sistem i tërë në këtë lloj sporti, i cili për hir të së vërtetës ishte dhe në një nivel shumë cilësor. Poligoni ka të bëjë shumë, të jep mbështetje, kurajë, ambientohesh. Kur ndërrohet poligon, kjo ndikon në rezultat, prandaj duhet që dy javë para të njihesh me poligonin. Sot unë stërvitem në poligonin e qytetit "Studenti". Edhe garat atje zhvillohen. Tirana ka dhe një poligon tjetër në Kombinat. Krahasuar me poligonin ku zhvillohet qitja, Kosova p.sh. e ka më të mirë. Por sporti ka të mirat dhe të këqijat e tij. Si çdo sport ka edhe kosto ekonomike, që jo rrallë herë ne shpenzojmë dhe nga të ardhurat personale, p.sh. sporti i qitjes me saçme më detyron shpesh t'i siguroj vetë ato.

A ju ka ndihmuar mbiemri Mata për t'u bërë kjo që jeni sot?

Po, sigurisht që më ka ndihmuar. Pasi, siç e thashë edhe në fillim, të ishe pjesë e familjes Mata ishte krenari në vetvete, se ishte një emër i nderuar në traditën e qitjes dhe për mua të isha pjesë e familjes ishte krenari. Jam ndjerë tepër e vlerësuar kur m'u dha pistoletë, sigurisht në sajë të rezultatit, por ama në çdo kohë që shkoja në poligon, poligoni për mua ishte hapur dhe unë e vlerësoja së tepërmi këtë. Nga ana tjetër në çdo kohë kisha konkurrencë kunatën, Dianën. Ajo ka qenë gjithmonë më e mirë. Të dyja kemi thyer rekordet. Por gara është garë dhe gjithsesi fitonte më i miri. Që të dyja mbajmë rekorde, që edhe sot e kësaj dite ende nuk janë thyer. Unë kam marrë pjesë edhe tek kategoria A edhe tek B. Diana ishte gjithmonë tek A-ja. Kush ishte më i mirë futej tek kategoria A. Çdo garë që kisha përpiqesha ta fitoja. Sporti kishte masivitet në atë kohë, evidentohet më i miri dhe ngrihet lart figura e më të mirit, për t'u ndjekur si shembull edhe

nga të tjerët. Sporti i qitjes ka pasur sportistë shumë të mirë që vlen për t'i përmendur, por sot disa, që me keqardhje e them, pasi janë më të mirët ata që kanë ikur nëpër botë, si trajnerja ime, Elisabeta Karabollë, në SHBA dhe Enkeleda Shehu, Manjola dhe Gresia në Itali. Ato kanë shkëlqyer edhe andej edhe pse emigrante. Megjithatë ato kanë kushte më të mira se sa ne. Garojmë bashkë, por nuk jemi në kushte të njëjta që nga pistoletë, të cilën ato e ndërrojnë më shpesh p.sh. e imja ka 10 vjet. Apo bazën materiale, e kanë më të mirë se sa ne. Është çanta e pajimeve, veshjet, këpucët, pistoletë, armët, poligoni, të cilat ndikojnë pothuaj në 10 pikë. Të japin siguri dhe një përballje më të mirë.

Ju keni një vajzë të rritur dhe jeni gjyshe, a keni menduar ndonjëherë ta bënit atë një sportiste në qitje?

Kur ishte e vogël, vajza ishte tepër kureshtarë dhe erdhi disa herë në poligon, por më tej ajo vazhdoi rrugë tjetër. Pas humbjes të tim shoqi, edhe pse isha vetëm 36 vjeç, nuk u ndava asnjëherë nga sporti dhe kam rritur e vetme vajzën adoleshente 16-vjeçare, por stërvitjen dhe sportin nuk e lashë asnjëherë, paralelisht edhe me punën që të siguroja të ardhurat ekonomike për familjen dhe rritjen e vajzës. Sakrifika dhe këmbëngulja ime ka qenë e madhe për të por edhe ajo vetë ka shkëlqyer dhe më ka nderuar. Jam krenare për arritjet dhe energjinë e asaj kohe, pasi që të ndjekësh çdo lloj sporti duhet të kesh karakter të fortë, vullnet, siguri dhe besim në vetvete dhe e them me krenari se vajza ma ka shpërblyer. Ka shkëlqyer me shkollimin e saj. I vura qëllim vetes që ajo të merrte një studim jashtë shtetit dhe sot ajo mban një post drejtues në një nga bankat e rëndësishme të Shqipërisë. Dhe unë gjatë gjithë kohës së rritjes të saj sportin nuk e lashë.

Si je para një gare?

Pozicionim!

Çfarë do të thotë formë fizike për një sportist qitjeje?

Gjithçka ka të bëjë me frymëmarrjen, pasi mbajtja e frymës ka të bëjë me përgatitjen fizike, ka të bëjë me pozicionimin, rezistencën, muskujt e krahut, të qafës, vullnetin etj., dhe për të gjitha këto të duhen shumë ushtrime të ndryshme, si vrap, pompa, ulje ngritje e të tjera që përkthohen në poligon, ku e gjithë forca jote të shkojë tek pozicionimi dhe forca e krahut. Mbajtja e frymës ka të bëjë me përgatitjen fizike, pra duhet stërvitje fizike. Janë ushtrime të ndryshme të cilat ruajnë formën sportive të qitës. Përveç anës psikologjike forcimi i muskujve të krahut është i rëndësishëm. Çdo ditë ju mund të më shihni në të njëjtën orë në vrapin përreth pistës, në ambientet sportive të garnizonit "Skënderbej", apo kur vazhdoj më tej me ushtrimet e tjera. Pastaj më vonë, pasdite shkoj çdo ditë në poligon me çantën e pajimeve në supe, pasi sa më shumë të shkëlqesh në stërvitje, aq më mirë je në garë.

Sa e angazhuar jeni ju dhe si e koordinoni përvojën tuaj me grupin e qitjes të ekipit të FA-së?

Klubi Sportiv Tirana, ka ekipin e vet që përbëhet nga 15 sportistë, ku unë jam një veterane. Por krahas këtyre ekipeve dhe klubeve sportive së fundmi është edhe ekipi i qitjes i Forcave të Armatosura. Stërvitja bëhet me trajnerë me armë si pushkë dhe pistoletë. Kam filluar të koordinohem me këtë ekip edhe për të shkëmbyer eksperiencë. Edhe ekipi i FA-së stërvitet me ne dhe merr pjesë në gara, të cilat janë 8-10 aktivitetet që bëhen në vit dhe ata ka dy vjet që marrin pjesë në këto aktivitete. Ata marrin pjesë në qitje njësoj si ne.



SIGURIA NË DETIN E ZI

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm: Rajoni i Detit të Zi ka qenë një pikënisje për veprimet agresive të Rusisë

Përpara takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bukuresht, në fund të këtij muaji, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoana falënderoi Rumaninë për udhëheqjen e fortë politike, ushtarake dhe diplomatike në NATO. Zoti Geoana foli në një aktivitet të organizuar nga Ministria Rumune e Mbrojtjes për ndikimin e luftës në Ukrainë në sigurinë e Detit të Zi dhe përshtatjen e vazhdueshme të NATO-s përmes Konceptit të ri Strategjik.

Zoti Geoana tha se për më shumë se dy dekada rajoni i Detit të Zi ka



qenë një pikënisje për veprimet agresive të Rusisë, të cilat prekin thellësisht partnerët kryesorë si Ukraina dhe kërcënojnë sigurinë aleate. "Kjo është arsyeja pse ne riafirmojmë rëndësinë strategjike të rajonit të Detit të Zi në Konceptin e ri Strategjik të NATO-s që liderët tanë miratuan në Madrid në Samitin e qershorit të kaluar", - tha ai.

Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia, në vitin 2014, NATO ka zbatuar përfundimisht në të madh të mbrojtjes kolektive në një brez. Pas pushtimit rus të Ukrainës, më 24 shkurt të këtij viti, NATO ka përfunduar ndjeshëm praninë e saj nga Baltiku në Detin e Zi dhe po rrit numrin e forcave të

gatishmërisë së lartë në të gjithë Aleancën në mbi 300 000.

"Ne përballemi me mjedisin më të rrezikshëm dhe të paparashikueshëm të sigurisë në një brez", - tha zoti Geoana. NATO mund të mbështetet tek Rumania që të vazhdojë të punojë për një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt të Detit të Zi dhe më gjerë. Ashtu si Rumania mund të llogarisë mbështetjen e saj në NATO që të mbetet e fortë, të mbetet e gatshme, të qëndrojë e përgjegjshme, të mbështesë partnerët tanë, të mbrojë popullin tonë dhe të mbrojë vlerat tona demokratike" - përfundoi ai.

"Të mos bëjmë gabim të nënvlerësojmë Rusinë"

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, diskutime mbi Ukrainën dhe lëvizshmërinë ushtarake me ministrat e mbrojtjes të BE-së

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, mori pjesë në një takim të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Europian (BE) në konfigurimin e tij të mbrojtjes, më 15 nëntor 2022. Sekretari i Përgjithshëm dhe ministrat e BE-së diskutuan mënyrat për të mbështetur më tej Ukrainën. Në prag të takimit, z. Stoltenberg tha se ishte e rëndësishme të mos nënvlerësohej Rusia, duke vënë në dukje se vendi ruan aftësi të rëndësishme dhe një numër të lartë trupash. Sekretari i Përgjithshëm, i cili ishte takuar me trupat ukrainase që po trajnoheshin në Britaninë e Madhe disa ditë më parë, nënvizoi gjithashtu rëndësinë e ofrimit të më shumë trajnimeve për forcat ukrainase. "Ne duhet të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën për aq kohë sa duhet me aftësi, por edhe me trajnime", - tha ai.

Lëvizshmëria ushtarake ishte gjithashtu pjesë e diskutimeve të takimit. Lëvizshmëria ushtarake është një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit NATO-BE, tha zoti Stoltenberg, duke përshëndetur progresin e bërë deri më sot, ndërsa theksoi rëndësinë e përfshirjes së më të plotë të aleatëve jo-BE. "Bashkëpunimi NATO-BE është aq i afërt si kurrë më parë dhe fakti që ne kemi qenë në gjendje ta ngremë bashkëpunimin NATO-BE në nivele të paprecedentë është veçanërisht i rëndësishëm tani, pasi jetojmë në një kohë më të rrezikshme ndërsa shohim luftën e vazhdueshme në Ukrainë. Unë pres që ne, natyrisht, do të diskutojmë luftën brutale të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës gjatë takimit tonë.

Ne të gjithë mirëpresim përparimin që forcat ukrainase kanë bërë gjatë ditëve të fundit, veçanërisht me çlirimin e Khersonit. Kjo është për shkak të trimërisë, guximit të forcave të Armatosura të Ukrainës. Në të njëjtën kohë, mendoj se është gjithashtu e rëndësishme që të mos bëjmë gabim të nënvlerësojmë Rusinë. Rusia ruan aftësi të konsiderueshme ushtarake, një numër të lartë trupash. Ne kemi parë se Rusia është e gatshme të pësojë viktima të mëdha dhe gjithashtu, kemi parë brutalitetin, jo më pak në zonat që janë çliruar. Sa brutalitet është ushtruar ndaj civilëve në ato territore", - tha në deklaratën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në prag të takimit të Këshillit të Punëve të Jashtme të BE-së në formatin e Mbrojtjes. "Pra, ne duhet të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën për aq kohë sa duhet me aftësi, por edhe me trajnime. Javën e kaluar vizitova një strukturë stërvitore në Mbretërinë e Bashkuar, ku aleatë të ndryshëm të



NATO-s ofrojnë trajnime për ushtarët ukrainas. Unë e mirëpres vendimin e BE-së për të krijuar trajnime për forcat ukrainase. Kjo do të plotësojë atë që Aleatët e NATO-s tashmë bëjnë. Është e rëndësishme që të ofrojmë më shumë stërvitje, sepse ukrainasit po bëjnë një betejë, e cila është e përgjakshme dhe

jashtëzakonisht sfiduese. Më lejoni të them gjithashtu se mirëpres përparimin që po bëjmë në lëvizshmërinë ushtarake, një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit NATO-BE, dhe është e rëndësishme që ne të kemi përfshirjen më të plotë të mundshme të aleatëve të NATO-s gjithashtu jo të BE-së", - tha ai.

Stabiliteti në rajonin e Ballkanit Perëndimor

NATO forcon dialogun politik me Serbinë dhe Bosnje-Hercegovinën

Zëvendës Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, Javier Colomina përfundoi një udhëtim në Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë. Në Serbi, ai u takua me zëvendëskryeministrin e Parë dhe ministrin e Jashtëm Ivica Dačić dhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes Millosh Vučević. Në Bosnje-Hercegovinë ai zhvilloi bisedime me kryetarin e Presidencës Sefik Xhaferovic, zëvendësmministrin e Punëve të Jashtme Josip Brkić dhe ndihmësmministrin për bashkëpunim ndërkombëtar në Ministrinë e Mbrojtjes Zoran Šainović.

Në Serbi, z. Colomina theksoi shtrirjen e partneritetit afatgjatë dhe reciprokisht të dobishëm NATO-Serbi dhe zhvillimin e tij në fusha të ndryshme të bashkëpunimit, në respekt të plotë të politikës së deklaruar të Serbisë për neutralitet ushtarak. Në dritën e situatës aktuale në veri të Kosovës, ai theksoi rolin e vazhdueshëm stabilizues që luan misioni i KFOR-it i udhëhequr nga NATO dhe i mandatuar nga OKB-ja, i cili garanton një mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. KFOR-i gjithashtu ofron kornizën e sigurisë në mbështetje të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Z. Colomina nënvizoi përkushtimin e NATO-s për stabilitetin në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe rëndësinë e saj strategjike për Aleancën, siç është bërë e qartë në Konceptin e ri Strategjik të NATO-s.

Në Bosnje-Hercegovinë, Z. Colomina përshëndeti miratimin e Programeve të Reformës 2021 dhe 2022 nga Këshilli i Ministrave të vendit, me synimin për të forcuar bashkëpunimin e tij me Aleancën. Ai përshëndeti gjithashtu zgjatjen e fundit të mandatit të EUPOR Althea dhe përsëriti se NATO vazhdon të mbështesë operacionin e udhëhequr nga BE, sipas marrëveshjeve të Berlin Plus. Ai vuri në dukje angazhimin e vendosur të NATO-s për të mbështetur sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës dhe strukturat e saj shtetërore, të cilat mbeten kyçe për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm në të gjithë rajonin. Ai gjithashtu nënvizoi rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme për çarjen e reformave përpara, për të mirën e të gjithë njerëzve të Bosnjë-Hercegovinës. Diskutimet prekën gjithashtu konsultimet midis NATO-s dhe Bosnje-Hercegovinës për finalizimin e një pakete mbështetjeje të zgjeruar që synon rritjen e qëndrueshmërisë së Bosnjë-Hercegovinës dhe modernizimin e strukturave të saj të mbrojtjes dhe sigurisë. Z. Colomina u takua edhe me zëvendësin kryesor të Përfaqësuesit të Lartë, Jonathan Mennuti, duke përsëritur mbështetjen e vendosur të NATO-s për përpjekjet e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë në Sarajevë.

MOMENT KRITIK PËR SIGURINË EUROPIANE

Kontributet holandeze për sigurinë e NATO-s dhe Ukrainës

Më 14 nëntor 2022, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua me ministrin e Punëve të Jashtme holandeze Wopke Hoekstra dhe ministrin e Mbrojtjes Kajsa Ollongren në Hagë. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti kontributet e fuqishme të Holandës për sigurinë aleate, duke përfshirë avionët për të mbrojtur krahun lindor të NATO-s, duke udhëhequr një nga grupet detare të NATO-s dhe duke marrë pjesë në grupet e betejës të NATO-s në Lituani dhe Rumani. Z. Stoltenberg mirëpriti gjithashtu planet holandeze për të rritur shpenzimet e mbrojtjes në vitet e ardhshme dhe për të mbajtur avantazhin teknologjik të NATO-s në një botë më konkurruese.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se të gjitha këto kontribute janë të rëndësishme, pasi përballemi me një moment kritik për sigurinë europiane. Duke folur për luftën brutale të agresionit të Rusisë dhe mbështetjen e NATO-s për Ukrainën, z. Stoltenberg tha se: "Tërheqja e Rusisë nga Kherson tregon guximin e jashtëzakonshëm të forcave të armatosura ukrainase. Por kjo tregon gjithashtu rëndësinë e mbështetjes sonë të vazhdueshme për Ukrainën". Ai theksoi se nuk duhet të bëjmë gabim të nënvlerësojmë Rusinë. Forcat e Armatosura Ruse ruajnë aftësi të konsiderueshme, si dhe një numër të madh trupash. Dhe Rusia ka demonstruar gatishmërinë për të pësuar humbje të



konsiderueshme. Ata gjithashtu kanë treguar brutalitet ekstrem. Të gjithë kemi parë skenat e tmerrshme nga territoret e çliruara, si dhe sulmet pa dallim ndaj civilëve dhe infrastrukturës kritike. Muajt e ardhshëm do të jenë të vështirë. Qëllimi i Putinit është ta lërë Ukrainën të ftohtë dhe të errët këtë dimër. Kështu që ne duhet të qëndrojmë në këtë kurs."

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Holandën për kontributet e saj bujare në Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës së NATO-s për Ukrainën, duke thënë se kjo do të financojë mbështetjen urgjente, si karburantet, veshjet dimërore, furnizimet mjekësore dhe sistemet kundër dronëve. Ai gjithashtu përshëndeti që Holanda do të japë 120 milionë euro të tjera ndihmë për Ukrainën, përfshirë tanket e përmirësuara çeke të betejës. "Konflikti aktual tregon gjithashtu rëndësinë e diversifikimit të furnizimeve tona me energji dhe të mbrojtjes së infrastrukturës sonë kritike", - tha ai.

Z. Stoltenberg tha se Holanda luan një rol të rëndësishëm për të kontribuar në qëndrueshmërinë e aleatëve të tjerë nëpërmjet porteve, rrjeteve të transportit dhe lehtësirave të importit të energjisë. Sekretari i Përgjithshëm shfrytëzoi gjithashtu rastin për të përkujtuar viktimat e shpërthimit të bombës në Stamboll të dielën, më 13 nëntor. "Ngushëllimet e mia shkojnë për të gjithë të prekurit dhe popullin turk", - tha ai.

Gjuha shqipe, amaneti i të parëve, simbol i identitetit kombëtar

Rishkruhet historia 20 - 25 nëntor 1972, mbledhet Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe

Kongresi i Manastirit nuk ishte vetëm kongres për gjuhën shqipe po pararendës i një kompozimi idesh gjithëpërfshirëse për çështjen e kombëtare. Ky kongres i madh për shqiptarët erdhi si thirrje e iniciativë e klubit "Bashkimi", dhe e dëshirës për unifikimin e gjuhës shqipe që në atë kohë ishte në disa versione. Kongresi pati përfaqësuesit më të shquar dhe atdhetarët e nacionalistët më të flaktë të Shqipërisë si: Gjergj Fishtë, Mithat Frashërin, Ndre Mjedën, Shahin Kolonjën, Bajo Topullin, Parashqevvi Qirjazin etj.

Për këtë u mbledhën nga 4 vilajetet: Janinës, Manastirit, Kosovës, Shkodrës si dhe nga shoqëritë shqiptare në Bukuresht, Sofjes, Filipolit, Kostancës, Egjiptit, 50 delegatë për diskutimin dhe marrjen e vendimeve për çështjen e gjuhës shqipe.

Në të kishte rryma të ndryshme heterogjene lëvizjesh dhe mendimtarësh nga të gjitha hapësirat shqiptare. Një grup reformist me në krye Mithat Frashërin ishin për diskutimin vetëm të gjuhës shqipe, motoja e tyre ishte "jo me pushkë po me penë". Një rrymë tjetër që vinte nga Shkupi, shqiptarët e Amerikës etj., kërkonin që kongresit t'i shtoheshin pikëpamjet politike dhe ekonomike.

Në këtë kongres u vendos që të përdorej alfabeti i Stambollit dhe ai i quajtur latin.

Nga ana tjetër u bënë dhe mbledhje të mbyllura, ku u diskutua raporti i Shqipërisë me regjimin e atëhershëm xhonturk, lufta për çështjet kombëtare dhe çështjet e zhvillimit të përgjithshëm në të gjitha aspektet të Shqipërisë së asaj kohe.

Vendimet që u morën në kongres u paraqitën në parlamentin turk, ku kërkohej:

Mësimi në gjuhën shqipe në të gjitha shkollat fillore dhe gjimnazet e ulëta, gjuha turke të mësohesh në vitin e katërt.

Ndalimi i subvencionit të shkollave të elementit ortodoks nga qeveria greke, shndërrimi i shkollave të të krishterëve në shkolla kombëtare.

Përdorimi i një pjesë të të ardhurave të vakëfeve për qëllime kombëtare.

Mbledhja e antikitetëve nga të katër anët e vilajetit dhe ruajtja e tyre në Muzeun e Elbasanit.

Zvogëlimi i shërbimit ushtarak në dy gjysma ose dy vjet; shqiptarët do të shërbenin vetëm në vilajetin e tyre, duke përjashtuar rastin e luftës.

Nënoficerët e ushtrisë të përbëheshin nga shqiptarët.

Oficerët e xhandarmërisë në Shqipëri të ishin shqiptarë.

Zgjedhja e kryetarëve të bashkisë të bëhej sipas sistemit të zgjedhjeve publike, të bëhej zgjerimi i kompetencave të tyre.

Hapja dhe shfrytëzimi i minierave si dhe ndërtimi e funksionimi i hekurudhave të shkonte në interes të Shqipërisë; të kufizohej ndërhyrja dhe ndikimi i të huajve përmes ligjit.

Në emërimin e nëpunësve civilë në vilajetet shqiptare t'u sigurohej shqiptarëve preferenca para kombësive të tjera.

Të gjithë të ardhurat e caktuara për punë botërore t'i lireshin administratës lokale, ndërsa një pjesë e të ardhurave të përgjithshme të përdorej për punime publike.

Ngritja e ekonomive dhe e shkollave të ulëta bujqësore.



● *Kongresi i Manastirit nuk ishte vetëm kongres për gjuhën shqipe po pararendës i një kompozimi idesh gjithëpërfshirëse për çështjen e kombëtare. Ky kongres i madh për shqiptarët erdhi si thirrje e iniciativë e klubit "Bashkimi", dhe e dëshirës për unifikimin e gjuhës shqipe që në atë kohë ishte në disa versione.*

Ekzekutimi i dënimeve me vdekje që parashikoheshin për krimet në Shqipëri.

E drejta e këshillave të sanxhakut dhe të vilajetit në caktimin e taksave të veçanta në shkolla.

Themelimi i universitetit shqiptar; në buxhetin e shtetit të parashiheshin për

çdo vit pesë bursa për shqiptarët që do të studionin në universitetet europiane.

Njohja zyrtare e gjuhës dhe e kombësisë shqiptare; në Nufus Tesqeret (letërnjoftim) të vihej shënimi: shqiptar i krishterë ose shqiptar mysliman.

Priftërinjtë katolikë e ortodoksë të

paguheshin nga shteti me qëllim që të pengohej përzierja dhe ndikimi i huaj, si ai i Austrisë, i Italisë dhe i Greqisë.

Rregullimi i lumit të Korçës dhe tharja e kënetës së Maliqit.

Kongresi i dytë i Manastirit

Në kushtet e represionit të xhon-

turqve kundrejt shkollave shqipe dhe masave të reja që morën ata, në kushtet gjithashtu të një përballje me këtë problem madhor nga rrethet dhe klubet e fshehta patriotike u pa e nevojshme të mbahej Kongresi i Dytë i Manastirit, nga data 1 deri më 6 prill 1910, ku u mbledhën 40 delegatë të shoqërive patriotike.

Si përfaqësues kongresistë ishin, Fehim Zavalani (kryetar i klubit qendror "Bashkimi"), Dervish Hima (Përfaqësues i Klubit të Stambollit), Petro Nini Luarasi, Tefik Panariti, Ferit Ypi, Qazim iliaz Dibra, Temak Gërmenji e shumë figura të tjera patriotike.

Delegatët e Kosovës erdhën me vonesë për shkak të vështirësive të atyre viteve. Pjesa e parë e kuvendit ishte e hapur, kurse një pjesë tjetër ishte përsëri si në 1908, me detyrë të mbyllura. Në këtë kongres u vendos:





Qendra e deriatëhershme e klubeve shpërngulet nga Manastiri në Stamboll; në gjirin e klubit të atjeshëm qendror do të formohej një këshill i posaçëm i përbërë nga deputetë patriotë. Në Stamboll do themelohej akademia që do merrej me botimin e librave, fjalorëve, gazetave.

Do të thirrej kongresi kombëtar në Janinë, ku do shqyrtohej puna e klubeve dhe do nxirrej rezoluta për qeverinë turke. Do të zgjidhej komisioni i lartë, ku do të drejtonte lëvizjen kombëtare në Shqipëri.

Do të zhvillohej propagandimi rreth veprimtarisë së shkrimit shqip dhe përhapjes së arsimit; të bëheshin përpjekje për themelimin e institutit pedagogjik në Shkup, që do të përgatiste kuadrin e mësimit për shkollat e mesme dhe nxjerrjen e gazetave shqipe.

Përmes një rekomandimi, kërkohej nga qeveria turke të ndërpritej çdo veprimtari dhe propagandë kundër gjuhës shqipe.

Megjithatë ky kongres kishte presionin e madh të qeverisë turke, e cila formoi shoqatën Arnavud Mahvil Maarifi (Rrethi Arsimit Shqiptar). Qëllimi i kësaj shoqate ishte zhvillimi i arsimit po me alfabet arab, nismë e marrë nga

veziri i madh Ferid Pasha.

Nga ana tjetër kjo pati një rezistencë të fortë nga Shoqata e Intelektualëve të Rinj Shqiptarë që ishte formuar gjithashtu në Stamboll. Qeveria këtu solli Galip Beun, i cili donte të organizonte propagandën kundër shkrimit shqip, t'i shpërbente klubet shqiptare dhe çorientimin e lëvizjes shqiptare.

Shefi i policisë së Stambollit, Galip Beu organizoi gjithashtu një grup për çorientimin e detyrave për shkrimin shqip në Vilajetin e Kosovës.

Me gjithë përkrahjen dhe instrumentalizimin që donin të bënin në Vilajetin e Kosovës, nuk ia arritën dot

ta kthejnë lëvizjen në favor të kundërt, të çorientimit të shkrimit shqip. Kjo lëvizje u braktis nga shqiptarët që iu bashkua lëvizjes së dalë nga Kongresi i Manastirit.

Rishkruhet historia

20 - 25 nëntor 1972,

mblidhet Kongresi i

Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

50 vjet më parë, u mbajt në Tiranë, me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë dhe me praninë e 87 delegatëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, padyshim ngjarja më e

rëndësishme për gjuhën tonë kombëtare pas Kongresit të Manastirit, që miratoi alfabetin me gërmat e arta.

Me Kongresin e Drejtshkrimit, gjuha shqipe mbërriti të ketë standardet e një gjuhe moderne, të unifikuar në normën drejtshkrimore, ashtu sikundër duhet të jetë në fakt gjuha, si elementi bazë e padyshim më i rëndësishëm i përveçimit të identitetit tonë kombëtar!

Prandaj, shteti shqiptar në radhë të parë, e më tej e gjithë bota kulturore e akademike shqiptare, por edhe i gjithë kombi ynë do të duhej të nderonte në këtë përvjetor, veprën e paçmuar për nga dimensionet e pesha patriotike, kul-

● *Me Kongresin e Drejtshkrimit, gjuha shqipe mbërriti të ketë standardet e një gjuhe moderne, të unifikuar në normën drejtshkrimore, ashtu sikundër duhet të jetë në fakt gjuha, si elementi bazë e padyshim më i rëndësishëm i përveçimit të identitetit tonë kombëtar!*

turore e shkencore e të gjithë delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të cilët ishin përfaqësuesit më të shquar të elitës shkencore e akademike nga gjuhësia, letërsia, historia e mësimdhënia!

Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe është shprehje e kristalizimit të normës letrare kombëtare në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore.

Ai pasqyron gjendjen e sotme dhe prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare, e cila mbështetet gjerësisht në gjuhën e folur të popullit. Duke ngritur në një shkallë më të lartë traditën e shkrimit të shqipes, drejtshkrimi i sotëm synon njësimin e mëtejshëm të normës së gjuhës letrare kombëtare mbi bazën e trajtave të përbashkëta që janë përvetësuar e përvetësohen prej saj.

Kongresi i zhvilloi punimet e tij nga 20 deri më 25 nëntor të vitit 1972, ku të pranishëm ishin 87 albanologë (delegatë) nga mbarë trevat shqiptare, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshë nga Italia.

Qëllimi i Kongresit ishte të përcaktonte parimet dhe drejtimit kryesorë të hartimit të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar.

Gjuha letrare u krijua që shqiptarët të kuptoheshin më lehtë me njëri-tjetrin dhe të vihej një standard i përhershëm drejtshkrimor.

Në unifikimin e standardeve të gjuhës shqipe, rol përcaktues ka pasur delegacioni nga Shqipëria.

Kongresi i Drejtshkrimit kishte konstatuar se Shqipja letrare kishte hyrë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj dhe se ajo sipas delegatëve funksionon si një gjuhë letrare e përbashkët dhe e njësuar në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore.

Nga Kongresi pesëditor ishte nxjerrë një rezolutë, ku ndër të tjera thuhej se: rregullat e drejtshkrimit të mbështeten sa më gjerë në trajtat e përbashkëta të gjuhës kombëtare shqipe.

Disa nga delegatët kryesorë në kongres ishin: historiani prof. Aleks Buda, prof. Androkli Kostallari, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të USHT në Tiranë, prof. Bedri Dedja, zëvendësministër i Arsimit dhe i Kulturës, prof. Dhimitër Shuteriqi, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, prof. Eqrem Çabej, gjuhëtar, prof. Idriz Ajeti, dekan i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, prof. Josif Ferrari, studiues arbëresh dhe profesor i gjuhës në Bari.

Për jetë nderim e mirënjohje të gjithë atyre që kontribuan 50 vjet më parë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të gjuhës tonë për të cilën Ndre Mjeda pati shkruar:

*“Geg’ e tosk’ malci, jallia,
Jan’ një komb, me u da s’ duron,
Fund e maj një a Shqyppnia,
E një gjuh’ t’ gjithë na bashkon!”*

Sipas kësaj filozofie të shprehur me aq largpamësi nga Mjeda, vlerësimi i Kongresit të Drejtshkrimit me realizëm e objektivitet për çfarë kontriboi në zhvillimin e gjuhës shqipe, e bën të domosdoshme një nismë të atyre përmasave, për të reflektuar gjithë zhvillimet që ka pësuar gjuha jonë e proceset nëpër të cilat ajo ka kaluar në këta 50 vjet,

Është një sfidë që i takon në radhë të parë bashkësisë së punëtorëve të gjuhës shqipe, por edhe të gjithë shkencëtarëve e intelektualëve që dinë të kuptojnë rëndësinë që ka përbushja e sfidave të tilla të mëdha e me interes kombëtar.



AKTI I BE-SË PËR LIRINË E MEDIAS

EDPS mirëpret objektivat e ndjekura në Aktin e propozuar të BE-së për Lirinë e Medias për të mbrojtur lirinë, pavarësinë dhe pluralizmin e medias në të gjithë BE-në. Liria e medias është një parakusht për funksionimin e shërbimeve të medias në tregun e brendshëm të BE-së dhe, më e rëndësishmja, një mundësi kyçe për sundimin e ligjit dhe llogaridhënien demokratike në BE.

Megjithatë, EDPS është i shqetësuar se masat e parashikuara për të mbrojtur gazetaret, burimet e tyre dhe ofruesit e shërbimeve mediatike të përfshira në Aktin e propozuar të BE-së për Lirinë e Medias mund të mos jenë efektive në praktikë. Në këtë drejtim, rekomandimet e EDPS-së janë të dyfishta. Së pari, për të sqaruar se çdo gazetar do të përfitonte nga mbrojtja e ofruar nga Ligji i propozuar për Lirinë e Medias. Së dyti, për të përcaktuar dhe kufizuar më tej mundësinë për të hequr dorë nga mbrojtja e burimeve dhe komunikimeve gazetareske, veçanërisht përjashtimet që lidhen me ndalimin e përgjimit të komunikimeve duke përdorur spyware ose forma të tjera të mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve mediatike.

Wojciech Wiewiórowski, EDPS, tha: “Ndërsa unë mbështes plotësisht

“Mbrojtje më të mirë për të gjithë gazetarët dhe ndalim të spyware-ve të avancuar ushtarakë”



objektivin e Propozimit, i cili synon të garantojë lirinë dhe pluralizmin e medias, jam i shqetësuar se masat e propozuara parashikojnë të parandalo-

jnë vendosjen e programeve spyware shumë të avancuara ushtarakë, të tilla si “Pegasus”, “Predator” apo të ngjashme, nuk janë të mjaftueshme për të mbro-

jtur në mënyrë efektive të drejtat dhe liritë themelore të BE-së, duke përfshirë lirinë e medias. Përjashtimet për zhvillimin ose vendosjen e këtij lloji të softuerit spyware duhet të jenë jashtëzakonisht të kufizuara dhe të përkufizohen me saktësi të madhe, si dhe të plotësohen me masa mbrojtëse të fuqishme për mbrojtjen e të dhënave, siç janë ato të sugjeruara në vërejtjet paraprahe të EDPS mbi softuerin spiun modern.

EDPS rekomandon gjithashtu që Akti i propozuar për Lirinë e Medias të përfshijë masa që garantojnë pavarësinë e autoriteteve dhe organeve të shteteve anëtare të BE-së të ngarkuara me shqyrtimin e shkeljeve të mbrojtjes së burimeve dhe komunikimeve gazetareske. Përveç kësaj, një bazë e qartë ligjore për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse të BE-së, duke përfshirë

autoritetet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave, sipas kompetencave të tyre përkatëse, duhet të përfshihet në Rregulloren e propozuar.

Duke kuptuar dhe mbështetur detyrimin e përfshirë në Rregulloren e propozuar për t'i bërë publike të dhënat personale të disa ofruesve të shërbimeve mediatike për të arritur transparencë dhe për çështje me interes publik, EDPS vë në dukje ndërhyrjen e mundshme me të drejtat themelore për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave që publikimi i këtij informacioni mund të sjellë. Prandaj, EDPS rekomandon të renditen në mënyrë eksplicite në Rregulloren e propozuar qëllimet e interesit publik për të cilat informacione të caktuara do të bëhen publike, si dhe kategoritë e të dhënave personale që do të bëhen publike në dritën e këtyre qëllimeve.

Kërcënimi në rritje ndaj qytetarëve për përdorimin e shtuar të pjesëve të lira dhe false të makinave

Përdorimi në rritje i pjesëve të rreme të makinave paraqet një rrezik në rritje sigurie për përdoruesit e rrugës, duke çuar në aksidente vdekjeprurëse dhe dëmtime të rënda trupore. Për më tepër, përdorimi i pjesëve false është një shkelje serioze e të drejtave të autorit të prodhuesve origjinalë. Për të trajtuar këtë problem në rritje, prokurorët dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit u mblodhën në Eurojust për të diskutuar se si të ndiqet penalisht ky krim në mënyrë më efektive. Një metodë është tarifimi kumulativ, duke shtuar akuzat të tilla si vrasja nga pakujdesia, shkaktimi i lëndimeve trupore dhe mashtrimi për shkeljet e të drejtave të autorit për të rritur nivelin e dënimit.

Montimi i pjesëve të rreme të makinave zakonisht ndodh kur pjesët origjinale zëvendësohen gjatë riparimeve. Për shkak të infiltrimit të pjesëve false në zinxhirin e furnizimit ligjor, pronarët e punishteve shpesh nuk janë as të vetëdijshëm për faktin se pjesët zëvendësuese që kanë blerë janë produkte të falsifikuara. Kjo mund të çojë në montimin e pajisjeve thelbësore me defekt, si p.sh. tavolinat e frenave, dhe të çojë në viktima në rrugë. Përveç pasojave fizike, prodhuesit dhe furnizuesit e pjesëve origjinale akuzohen gabimisht dhe humbasin besueshmërinë dhe/ose të ardhurat e konsiderueshme.

Motori i makinës

Prodhimi i pjesëve të falsifikuara është një fenomen kriminal në rritje me marzhe të larta fitimi. Një studim i Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Europian (EUIPO) tregon se ndërsa nga të gjitha mallrat e rrezikshme të sekuestruara 7% janë



pjesë makinash false, ato janë deri tani produktet më të vlefshme të konfiskuara. Gjatë pandemisë COVID-19, shitja e produkteve të falsifikuara u zhvendos në platformat e tregtisë elektronike në internet si eBay, Wish, AliExpress, Alibaba dhe rrjetet sociale si Instagram dhe Facebook.

Ndër autorët, prodhimi i pjesëve false shihet shpesh si një krim ‘pa viktima’ dhe i ashtuquajtur krim me fitim të lartë/rrezik të ulët. Dënimet në të gjithë Bashkimin Europian mbeten relativisht të ulëta, veçanërisht nëse nuk ka akuzat për vrasje nga pakujdesia ose vepra të ngjashme të shtuara në aktakuzat. Organizatat kriminale arrijnë të prodhojnë pjesë false me çmim të ulët dhe në vëllime të larta, duke shmangur kontrollin e sigurisë. Hetimet për raste të tilla janë të rënda dhe ndjekja penale e tyre shpesh rezulton të jetë e vështirë.

Projekti i Krimit të Pronësisë Intelektuale të Eurojust organizoi një seminar praktik në bashkëpunim të ngushtë me EUIPO për të shkëmbyer praktikat më të mira midis prokurorëve dhe ekspertëve nga kompanitë private dhe për të siguruar një qasje koherente në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e treta.

Diskutimi u fokusua në mundësinë

e përdorimit të akuzave kumulative për krime të pronësisë intelektuale me vepra të tjera të rënda penale, përveç shkeljes së të drejtës së autorit. Për shembull:

- vrasja nga pakujdesia, në rast të një aksidenti vdekjeprurës;
- sulmi/bateria, në rastet kur është shkaktuar lëndim trupor por nuk është rrezikuar jeta e njeriut; dhe
- mashtrim, nëse pjesa false është instaluar pa dijeninë e pronarit të makinës me çmimin e produktit origjinal nga teknikat e servisit.

Kjo qasje u mundëson prokurorëve të trajtojnë vepra të shumta penale, duke siguruar që autorët të dënohen për tërë veprimtarinë e tyre kriminale, dhe jo vetëm për krimin më mbizotërues. Kjo do të rezultonte në dënime më të larta, ndërkohë që do të lejonte përdorimin e metodave dhe taktikave të veçanta hetimore të rezervuara për krimet që konsiderohen më të rënda nga ligjëvënësist. Një mënyrë tjetër për ta bërë këtë lloji krimi më pak fitimprurës është të jemi më të rreptë në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të kriminelëve që prodhojnë dhe shesin produkte të falsifikuara. Gjatë seminarit, pjesëmarrësist ranë dakord të bëjnë analiza të mëtejshme të aktiviteteve kriminale në lidhje me pjesët false. Ata gjithashtu hartuan procesin hetimor, duke parë nga afër të gjitha fazat e një çështjeje dhe bashkëpunimin me prodhuesit e makinave dhe pjesëve, duke përshkruar të gjithë elementët e nevojshëm për ngritjen e aktakuzave të suksesshme. Kjo përfshin procedurat për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe industrisë.

Banka Qendrore Europiane: Rreziqet po rriten me përkeqësimin e kushteve ekonomike dhe financiare

1. Familjet dhe firmat përballen me sfida të shumta, duke përfshirë dobësimin e perspektivës ekonomike, inflacion më të lartë dhe kushte më të shtrënguara financiare.
2. Likuiditeti i zvogëluar i tregut rrit rrezikun e rregullimeve të çrregullta të çmimeve të aktiveve, të cilat mund të testojnë qëndrueshmërinë e fondit të investimeve.
3. Qeveritë duhet të sigurojnë që mbështetja për sektorët vulnerabël të jetë në shënjestër dhe të mos ndërhyjë në normalizimin e politikës monetare.

Rreziqet për stabilitetin financiar në zonën e euros janë rritur mes çmimeve të larta të energjisë, inflacionit të ngritur dhe rritjes së ulët ekonomike, tregon Rishikimi i Stabilitetit Financiar i nëntorit 2022 i publikuar nga Banka Qendrore Europiane (BQE). Në të njëjtën kohë, kushtet financiare janë shtrënguar pasi bankat qendrore veprojnë për të frenuar inflacionin. “Njerëzit dhe firmat tashmë po ndiejnë ndikimin e rritjes së inflacionit dhe ngadalësimin të aktivitetit ekonomik”, - tha zëvendës presidenti i BQE-së, Luis de Guindos. “Vlerësimi ynë është se rreziqet për stabilitetin financiar janë rritur, ndërsa një recesion teknik në zonën e euros është bërë më i mundshëm.”

Këto zhvillime të fundit po rrisin cënueshmërinë e familjeve, firmave dhe qeverive që mbajnë më shumë borxhe. Ato gjithashtu po shtojnë streset e tregut financiar dhe po testojnë elasticitetin e fondeve të investimeve. Për më tepër, të gjitha këto dobësi mund të shpalosen njëkohësisht, duke përforcuar potencialisht njëra-tjetrën.

Sfidat e sektorit të korporatave janë rritur mes kostove më të larta të energjisë dhe inputeve të tjera, me fitimet që pritet të bien me rritjen e kostove të financimit. Nëse perspektiva përkeqësohet më tej, nuk mund të përjashtohet një rritje në frekuencën e dështimeve të korporatave, veçanërisht në mesin e firmave me intensitet energjie.

Inflacioni, si dhe rritja e faturave të gazit dhe energjisë elektrike, po godet gjithashtu familjet, duke ulur fuqinë e tyre blerëse dhe duke ulur potencialisht aftësinë e tyre për të shlyer kreditë. Familjet me të ardhura më të ulëta që në përgjithësi shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për energji dhe ushqim janë veçanërisht të prekura.

Ndërsa firmat dhe familjet e shohin gjithnjë e më sfiduese shërbimin e borxheve të tyre, bankat mund të përballen me humbje më të larta kredie në afat të mesëm. Ndërsa sektori bankar ka parë kohë e fundit një rikuperim të përfitueshmërisë pasi normat e interesit janë rritur, ka shenja fillestare të përkeqësimit të cilësisë së aktiveve, të cilat mund të kërkojnë provizione më të mëdha. Shumë qeveri kanë ofruar mbështetje fiskale për firmat dhe familjet për të zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve të energjisë. Megjithatë, nivelet e larta të borxhit të qeverisë pas pandemisë, të shoqëruara me kushte më të shtrënguara financiare, kufizojnë hapësirën për masat e zgjerimit fiskal që nuk shkaktojnë rreziqe për qëndrueshmërinë e borxhit. Prandaj, mbështetja duhet të jetë e përkohshme dhe e synuar për ata që janë më të prekurit. Pasiguria rreth perspektivës për inflacionin dhe normat e interesit ka rritur rrezikun e rregullimit të çrregullt të çmimit të aktiveve në tregjet financiare, pavarësisht korrigjimeve të fundit. Shumë fonde investimi mbeten shumë të ekspozuara ndaj vlerësimeve të mëtejshme dhe humbjeve të kredisë. Ato me mospërputhje të mëdha strukturore të likuiditetit dhe rezerva të ulëta monetare janë veçanërisht të ndjeshme ndaj dislokimeve të tregut dhe rrjedhjes së fondeve. Zvogëlimi i likuiditetit në disa tregje financiare mund të përbëjë gjithashtu sfida për rregullimin e portofolit ose mblidhjen e fondeve. Ai gjithashtu rrit rrezikun e thirrjeve të papritura të mëdha të marzhit, të cilat mund të përkeqësojnë dinamikën e pafavorshme të tregut nëse fondet detyrohen të shesin aktive për t'i përmblusur ato. Në përgjithësi, sistemi bankar i zonës së euros është i pozicionuar mirë për të përballuar shumë rreziqe, pjesërisht për shkak të reformave rregullatore dhe të politikave të kujdeshme të dekadës së fundit. Duke pasur parasysh përkeqësimin e perspektivës ekonomike dhe financiare, politikave të synuara makroprudenciale, si p.sh. buferat e kapitalit, mund të ndihmojnë në forcimin e mëtejshëm të elasticitetit të sistemit financiar. Dobësitë dhe rreziqet e vazhdueshme në sektorin financiar jo bankar kërkojnë vëmendje të madhe nga mbikëqyrësit përkatës. Nevojitet një progres urgjent në kuadrin rregullator për të rritur qëndrueshmërinë e sektorit, veçanërisht për të adresuar mospërputhjet e likuiditetit dhe levave.

Aeroplani hapësinor amerikan pa pilot, me energji diellore, kthehet pas 908 ditësh

Një aeroplan hapësinor ushtarak amerikan, pa pilot, u ul herët të shtunën pasi kaloi një rekord prej 908 ditësh në orbitë për misionin e tij të gjashtë dhe duke kryer eksperimente shkencore.

Automjeti me energji diellore, i cili duket si një anije kozmike në miniaturë, u ul në Qendrën Hapësinore "Kennedy" të NASA-s. Misioni i tij i mëparshëm zgjati 780 ditë.

"Që nga lëshimi i parë i X-37B në vitin 2010, ai ka thyer rekorde dhe i ka ofruar kombit tonë një



aftësi të pakrahasueshme për të testuar dhe integruar me shpejtësi teknologjitë e reja hapësinore", - tha Jim Chilton, një nënkryetar i lartë për Boeing.

Për herë të parë, avioni hapësinor priti një modul shërbimi që kryente eksperimente për Laboratorin e Kërkimeve Detare, Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-së dhe të tjerë. Moduli u nda nga automjeti përpara se të ç'orbitohej për të siguruar një ulje të sigurt. Midis eksperimenteve ishte një satelit i quajtur "FalconSat-8" që u projektua dhe u ndërtua nga kadetët e akademisë në partneritet me Labora-

torin Kërkimor të Forcave Ajrore. Ai u vendos në tetor 2021 dhe ende mbetet në orbitë.

"Ky mision thekson fokusin e Forcës Hapësinore në bashkëpunimin në eksplorimin e hapësirës dhe zgjerimin e aksesit me kosto të ulët në hapësirë për partnerët tanë, brenda dhe jashtë Departamentit të Forcave Ajrore", - tha gjenerali Chance Saltzman, shefi i Operacioneve Hapësinore.

X-37Be tani ka fluturuar mbi 1.3 miliardë milje dhe ka kaluar gjithsej 3 774 ditë në hapësirë.

Hulumtimet zbulojnë një ndikim të papërfillshëm klimatik nga rrjedhja e fundit e metanit nga tubacionet "Nord Stream"

Studiuesit nga Instituti i Fizikës Atmosferike, Akademia Kineze e Shkencave, vlerësuan ndikimin e mundshëm klimatik të metanit të rrjedhur, duke miratuar kuadrin e ruajtjes së energjisë të Raportit të Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike.

Më 26 shtator 2022, "Nord Stream" 1 dhe 2, dy tubacione nënjore për transferimin e gazit natyror nga Rusia në Gjermani, u prishën qëllimisht. Sasi masive gazesh, kryesisht metani, u larguan në oqean dhe më pas u lëshuan në atmosferë.

Metani është gazi i dytë serrë antropogjen më i bollshëm pas CO₂, por ka një efekt serë shumë më të fortë. Prandaj, nëse ndikimet negative klimatike do të lindnin nga ky incident u bë një shqetësim kryesor në mbarë botën. Një artikull i botuar në "Nature" komentoi këtë çështje, por nuk u bënë përfundime sasiore.

Kohët e fundit, studiuesit nga Instituti i Fizikës Atmosferike dhe Akademia Kineze e Shkencave, vlerësuan ndikimin e mundshëm klimatik të metanit të rrjedhur, duke miratuar kuadrin e ruajtjes së energjisë të Raportit të Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC AR6), të publikuar në 2021. Gjetjet e tyre janë publikuar së fundmi në "Advances in Atmospheric Sciences".

Pasi u mblodhën të gjitha vlerësimet e sasisë totale të metanit të rrjedhur në dispozicion në mediat botërore pas incidentit, u zbulua se vlerësimet më të hershme (1-2 ditë pas) arritën deri në 0.5 milion ton (Mt). Megjithatë, më vonë u bë e qartë se sasia e metanit që rrjedh ka të ngjarë të jetë shumë më e ulët se sa është vlerësuar fillimisht. Në veçanti, një ekip nga Universiteti Nanjing, Kinë, dha një vlerësim më të saktë prej 0,22 ± 0,03 Mt, duke u mbështetur në vëzhgime të shumta, duke përfshirë ato nga satelitët me rezolucion të lartë.

Kjo vlerë vërtetoi se ky ishte emetimi më i madh i metanit në një ngjarje të vetme në historinë njerëzore, më shumë se dyfishi i aksidentit të Aliso Canyon në Kaliforni në 2015. Megjithatë, sipas IPCC AR6, emetimet vjetore të metanit nga sektorët e naftës dhe



gazit arritën në 70 Mt gjatë periudhës 2008-2017. Metani i rrjedhur nga tubacionet "Nord Stream" ishte i barabartë me vetëm 1 ditë emetime nga këta sektorë.

IPCC AR6 gjithashtu theksoi se metani në atmosferë hiqet gradualisht duke reaguar me radikale të caktuara, si radikali hidroksil, duke rezultuar në një jetëgjatësi të përafërt 10-vjeçare, e cila është jetëshkurtër në krahasim me CO₂. Kjo do të thotë se ndikimi klimatik i metanit varet nga horizonti kohor, gjë që i ndërlikon gjërat kur përpiqet ta llogarisë atë drejtpërdrejt. Në vend të kësaj, studiuesit bënë një vlerësim indirekt me ndihmën e konceptit të "potencialit të ngrohjes globale". Konkretisht, ata përcaktuan se sasia e nxehtësisë së akumuluar për njësi masë të metanit në 20 vitet e ardhshme pas emetimit të tij në atmosferë është 82.5 herë më e madhe se ajo e CO₂.

Më pas, të armatosur me këtë informacion, ata ishin në gjendje të llogarisin se kur merret parasysh një horizont kohor prej 20 vjetësh,

ndikimi klimatik i metanit të rrjedhur është i barabartë me atë të 20,6 Mt CO₂, i cili do të rriste përqendrimin e CO₂ në atmosferë me vetëm 0,0026 ppm. Bazuar në vlerësimet më të reja në IPCC AR6 të forcës efektive të rrezatimit nën dyfishimin e CO₂, reagimet klimatike dhe efikasitetin e marrjes së nxehtësisë së oqeanit, nën kuadrin e ruajtjes së energjisë, temperatura mesatare globale e ajrit sipërfaqësor në teori do të rritet me 1,8 × 10⁻⁵.

"Një ngrohje kaq e vogël nuk mund të perceptohet në ekosistemet apo shoqërinë njerëzore", - shpjegon dr. Xiaolong Chen, autori i parë i studimit. "Megjithatë, metani antropogjen ka qenë nxitësi i dytë më i madh i ngrohjes globale dhe emetohet nga sektorë të shumtë të bujqësisë dhe industrisë. Nëse do të arrijmë objektivin e ngrohjes nën 1.5^o ose 2^o të përcaktuar në teori do të rritet me 1,8 × 10⁻⁵.

Trupat e Marinës Amerikane planifikojnë luftëra ku robotët vrasin njëri-tjetrin

Marinsat amerikanë të caktuar në skuadrën 3 të mjeteve ajrore pa pilot të marinës, Grupi 24 i Avionëve Detarë, Krahu i Parë i Aeroplanit Detar, përgatiten të lëshojnë një Blackjack RQ-21A në Kompleksin e Mbrojtjes Ajrore të Cannon, pranë Yuma, Ariz., 16 shtator 2021. Foto e korpusit nga Lance Cpl. Rachaelanne Woodward).

Udhëheqësit e marinës po parashtrijnë një vizion më të detajuar dhe konkret për përdorimin e platformave pa pilot dhe dronëve që përfshin gjëra të tilla si linjat e furnizimit të drejtuar nga robotët dhe luftimet me robotët në vazhden e stërvitjes së madhe detare në Paqësor.

Duke folur me gazetaret nga "Defense One", gjenerali Joseph Clearfield, zëvendëskomandanti i Korpusit për forcat e tij në Paqësor, shpjegoi se "udhëheqësit po shikojnë një të ardhme ku ne jemi në gjendje të përdorim robotë në misionin vdekjeprurës".

"Unë mendoj se ne jemi në gjendje t'i përdorim ato për misione për t'i mbajtur ata më shumë në rrezik dhe më pas të përdorim robotë për të shkatërruar robotë të tjerë", - tha Clearfield. "Aty na ka çuar eksperimentimi ynë". Oficeri më i lartë i Trupave Detare, Gjenerali David Berger, shkoi edhe më tej dhe shpjegoi se ai sheh një të ardhme ku automjetet pa pilot dhe robotikë përbëjnë një pjesë të zinxhirit logjistik që do të mbante njësitë e marinsave të furnizuara ndërsa luftojnë në ishuj të largët. Berger shpjegoi se, sipas tij, platformat pa pilot së shpejti do t'i lejojnë marinsat të kryejnë logjistikën taktike dhe operacionale, "...sepse nëse i keni të dhënat, e dini se ku janë njësitë, gjurmimi do të dijë se ku nevojiten disa gjëra në një moment të caktuar kohor dhe gjeografik në të ardhmen".

"Karburenti, municionet mund të zhvendosen tek ata për t'i takuar atje në vendin dhe kohën e duhur, të gjitha në mënyrë autonome", - shpjegoi Berger. Që kur Korpusi i Marinës filloi të përqendrohej nga orientimi i tij në Luftën kundër Terrorit si një "forcë elitare kundër kryengritjes" në atë që i kushton më shumë rëndësi rrethjeshë të saj amfibe dhe taktikave të kërcimit të ishujve, ka pasur gjithashtu një fokus më të madh se si marinsat do të furnizoheshin në ato ishuj.

Dronët tani duket se po marrin një rol më të madh në ato plane. "Komandanti ynë ka folur për përdorimin e tyre për të lëvizur logjistikën ... naftë, vaj dhe lubrifikantë, ujë të ëmbël, municione", - tha Clearfield. Berger foli gjithashtu për planet për të përdorur automjetet pa pilot dhe autonome për të transportuar trupa të plagosur.

"Mund të ketë mjekë, trupa në pjesën e pasme të atij automjeti ose në pjesën e pasme të atij avioni, por askush nuk po fluturon", - shtoi ai. Dronët tani duket se po marrin një rol më të madh.

Pavarësisht nga planet e mëdha që liderët po parashtrijnë, shumë nga aftësitë që po sugjerohen aktualisht nuk janë zhvilluar apo testuar.

Gjatë stërvitjes së fundit "Rim of the Pacific" (RIMPAC), një ngjarje dyvjeçare, me shumë vende të mbajtura në Hawaii dhe San Diego, që cilësohet si më e madhja në botë, midis 38 anijeve kishte vetëm katër prototipa të anijeve sipërfaqësore pa pilot. Sipas një njoftimi për shtyp të Marinës, "katër dronët mbartnin ngarkesa, siguronin inteligjencë dhe më e rëndësishmja, mblidhnin të dhëna në një mjedis të botës reale".

Trupa e Marinës ka vazhduar të rrisë arsenalin e saj të dronëve MQ-9 Reaper, por edhe Berger pranon se "nuk është një platformë e re". Ai e sheh atë si hapjen e rrugës për aftësi më të mëdha në rrugë.

Megjithatë, edhe nëse teknologjia zhvillohet siç shpresojnë udhëheqësit, ka çështje të tjera për t'u zgjidhur. Për shembull, tentativa për vjedhjen e fundit të tre prej anijeve dronë të Marinës nga Irani ka ngritur pikëpyetje në lidhje me efikasitetin dhe sigurinë e platformave.

Plus, Kongresi nuk është regjistruar ende për të paguar për teknologjinë e re. Vitin e kaluar, ligjvënësit hodhën poshtë planin e Marinës për të blerë më shumë anije-dronë për shkak të shqetësimeve se platformat ishin të paprovuara dhe shërbimi nuk kishte përcaktuar mjaftueshëm një strategji. Një ndihmësi i komitetit u tha gazetarëve vitin e kaluar: "Nëse shikoni strategjinë e blerjes (të Marinës), nuk ka vlerë asnjë hendek midis asaj që ata i quajnë këto anije prototip dhe kur ato hyjnë në prodhimin aktual serial.

"Ne nuk besojmë se kjo është një strategji e shëndoshë", - tha ndihmësi, duke shtuar se ligjvënësit ishin të shqetësuar për një përsëritje të programit tashmë të diskutueshëm të anijeve luftarake bregdetare.

Konstantin Toropin, Military.com

“Simbol mbi dallgë”

Njohje me autorin ushtarak

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Astrit Aliaj ka lindur më 7 prill 1956, në Burrel. Studimet e larta i kreu pranë Akademisë së Detarisë në Vlorë dhe i përfundoi në vitin 1980, ku është titulluar “Oficer Komandues”. Ka shërbyer në detyra të rëndësishme në Flotën Luftarake Detare dhe ka punuar si pedagog e punonjës shkencor, në Akademinë e Detarisë. Në vitet 2000-2003 kreu detyrën e komandantit të Akademisë së Detarisë. Ndërsa në vitet 2003-2009, kreu detyrën e atashut Ushtarak të Mbrojtjes të RSH në Itali, Spanjë, Zvicër, rezident në Itali. Prej vitit 2011-2017, kreu detyrën e drejtorit në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare në Durrës. Në vitet 2017-2020 kreu detyrën e prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Astriti ka dy nivele Master: në nivelin e parë “Studime Ndërkombëtare Strategjike Ushtarake”, në Universitetin “LUISS” në Romë, Itali (2001-2002) dhe niveli i dytë “Studime të Avancuara në Sigurinë Ndërkombëtare”, në Universitetin Shtetëror në Perugia, Itali (2009-2010). Ai është autor i doktoraturës me temë “Pavarësia e Kosovës dhe rruga Euro-Atlantike”, mbrojtur në Universitetin Shtetëror, Fakulteti i Shkencave Politike, në Perugia, Itali në gjuhën italiane, botuar pranë Institutit të Lartë të Studimeve të Mbrojtjes në Romë, Itali në vitin 2010. Ai ka publikuar shkrime në shtypin shqiptar, si në fushën e diplomacisë, sigurisë kombëtare dhe të arsimit ushtarak. Në vitin 2021 botoi librin monografi “Një jetë kushtuar mjekësisë”, ndërsa “Simbol mbi dallgë” është libri që i kushtohet ushtarakut të lartë të Flotës Luftarake Detare, Qemal Hysaj.

Një anije në lundrim

Libri është i ndërtuar në disa kapituj dhe në fillim ka një parathënie të bërë nga një ushtarak i lartë i marinës, Seit Jonuzaj, si dhe një dedikim. Kapitulli i parë flet për detarinë shqiptare, Adriatikun si urë lidhëse Lindje-Perëndim, Shqipëria, shtet i lashtë detar, me tradita të lashta detarie, me flota detare të zhvilluara, si dhe ngritja e Marinës Ushtarake Mbretërore. Kapitulli i dytë i kushtohet krahinës së Lopësit, ku vend të rëndësishëm zënë problemet pozicioni gjeografik, fiset, fshati Sinanaj, Mamuginajt, trashëgimia gjinore e fisit Hyso-Çukaj, gjendja ekonomike, shoqërore, arsimimi, kultura dhe kulti fetar, si dhe fëmijëria e personazhit të librit. Kapitulli i tretë i kushtohet luftës partizane, ku vend të rëndësishëm zënë problemet, ndjenja dhe aktiviteti i atdhetarizmit të fisit Hyso-Çukaj, pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste, Lufta Italo-Greke, Qemali partizan në Brigadën e V Sullmuese, kalimi i brigadës për çlirimin e Kosovës dhe Bosnje-Hercegovinës, kapitullimi i Gjermanisë naziste, si dhe kujtime dhe refleksione nga jeta ime partizane. Kapitulli i katërt i kushtohet arsimimit në shkollat ushtarake, ku zënë vend trajtesat: Qemali nxënës në shkollën ushtarake të “Kadetëve” në Tiranë, në shkollën e Marinës në Split, në Shkollën e Lartë Ushtarake Detare “Kirov” në Baku-Azerbajxhan, student-oficer në Akademinë e Ndërtimit të Anijeve dhe të Armatimit “Krillov” në Leningrad.

Organizimi i Flotës Luftarake Detare përbën kapitullin e pestë dhe analizohen problemet si: lindja e Flotës



Ushtarake mbas çlirimit, riorganizimi i saj, situata politike, ekonomike dhe ushtarake e dy blloqeve ushtarake NATO dhe Traktati i Varshavës, historia e Bazës Detare të Vlorës dhe lundrimi me nëndetëset nga Kaliningradi (Letoni) në Pashaliman (Vlorë). Në një kapitull më vete është trajtuar shkolla e anijerisë, si shtyllë vertebrale e detarisë, ku trajtohen në mënyrë shkencore problemet kuadrot detare, kushti themelor i zhvillimit të detarisë, dallgët e jetës që e shoqëruan në karrierën ushtarake, hapja e Shkolës së Lartë të Oficerëve të FLD, një eveniment historik i Detarisë Shqiptare. Kapitulli i shtatë i kushtohet karrierës ushtarake të komandantit Qemal Hysaj në Grupin MRU në Sazan, ideja e krijimit të Regjimentit të Anijeve të Sazanit, emërimi komandant i RA në Sazan, përbërja, vartësia, pasqyra e emërimit të anijeve të RA, aktiviteti për ruajtjen e regjimit operativ të hapësirës detare, etj.

Kapitulli më interesat, i teti, është ndërtuar me opinione, kujtime, ku përshkruhet tërë jeta e Qemalit në shoqëri, shërbim ushtarak, familje dhe shokët. Vend zënë shkrimet: “Lundrimi i fundit”, “E diel”, “15 janar 1984”, “Fotografia e fundit me uniformën ushtarake”, “Dorëzimi i numrit të telefonit”, “Një dallgë që desh shkatërrroi çdo gjë”, “Kundëradmiral Abdi Mati dhe Flota Luftarake Detare”, “Përgatitja e Fjalorit të termave të Detarisë”, “Vlerat e Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it”, etj. Në libër zënë vend të rëndësishëm dokumentet arkivore, titujt e nderit të marrë në jetë, foto që shoqërojnë një jetë të gjallë ushtarake etj.

Mamuginajt dhe fjala e ngrohtë

Nga leximi i librit historik që kemi në duar, të autorit tashmë të njohur Astrit Aliaj, nuk do shumë mundim të flasësh për Qemal Hysajn, sepse libri i ngjan atij qelqit që, kur drita bie mbi

të, ai nga çdo anë lëshon rreze. Autori nëpërmjet personazhit kryesor të librit, i drejtohet kujtesës dhe kjo i ka dhënë me bujari, sepse bujare dhe pa të meta ishte vetë jeta e Qemal Hysajt. Personazhi i librit nga Mamuginajt u ngrit në luftë. Qemali bashkë me shokët e tij të jetës, i kuptoi të vërtetat e jetës, sepse bashkë kishin ëndërruar, bashkë ishin rritur dhe bashkë iu futën luftës për çlirim. Të gjithë u rreshtuan partizanë, Zano, Serveti,

Hamdiu, për të vazhduar nga fisi i Çukajve, Tekiu, Qemali, Xheviti etj. Mbeti yll i pashuar Servet Merko Merkaj në altarin e lirisë, duke marrë me vetë bukurinë e tij dhe duke lënë pas amanetet: fitojeni lirinë, mbrojeni lirinë, ndërtojeni jetën, ashtu siç e ëndërruam...

Me një ndjenjë dashurie dhe mirësie, autori e përshkruan mjaft bukur personazhin krzesor, Qemal Hysaj, që u betua për luftë. Vatra e shtëpisë bujare e Hysajve ngrohte këdo që kishte nevojë të dëgjonte një fjalë-këshillë për një rrugëdalje kur e shtrëngonte halli. Hysajt nuk patën pasuri veç fjalës së ngrohtë e të mençme, që e falnin pa ngurrim. Mamuginajt dhe sot përmenden për këto cilësi të njerëzve me nder e me zakone për t'u respektuar. Të tillë ishin dhe mbetën Tekiu, Qemali dhe Xheviti. Më i riu, Qemali, mori nga Mamuginajt shëmbëllesën e saj të vërtetë, që i shfaqej në rrugët e jetës, duke i kërkuar birit të saj atë çka i kishte dhënë: guximin, ndershmërinë dhe besnikërinë ndaj atdheut, të mëkuara këto në tregim e vatrës dhe të këngës, bashkë me qumështin nga nëna dhe të thëna si këshilla brilante nga babai, i ditur dhe luftëtar për të arritur çdo liri e drejtësi.

Përgatitja për t'u bërë burrë

Në libër, ushtaraku madhor i Forcës Detare, Astrit Aliaj, na përshkruan me mjaft hollësi, tipar kryesor dhe i veçantë në shkrimet e tij, jetën e luftëtarit të ushtrisë partizane, i cili në qershor të vitit 1940, përfundoi me nota të mira shkollën. Në një moshë të vogël, shkoi me xhaxhain çoban për të ruajtur bagëtitë. Ishte ky veprim, si të thuash riti, përgatitja për t'u bërë burrë dhe për të ecur përpara. Aty në ruajtjen e deleve, Qemali dëgjonte për aksionet që kryenin partizanët. Ishte fundi i korrikut 1942, kur shkoi në Sev-

aster me xhaxhain, rrugës pa me sytë e tij shtyllat e telefonave të rrëzuar dhe telat e këputur nga aksioni partizan. Dëgjoi fillimin e një beteje pushkësh, mitralozash, bombash dhe vërshtëllimin e plumbave mbi Dorëz nga Mali i Bardhë, ndërsa në xhade, afër fshatit, pa dy fshatarë të pushkatuar. Fundi i vitit 1943 dhe fillimi i vitit 1944, Qemali rrëfen se “sa herë që lajmëroheshim se po vinin gjermanët nga Vlora apo Tepelena, largoheshim nga fshati dhe fshiheshim lart këmbëve të malit dhe përrrenjve, njerëz e bagëti, deri sa kalonte rreziku dhe ktheheshim përsëri në fshat. Kështu Qemali u përgatit për betejet e mëdha që qëndronin përpara.


Hajdar Aranitasi, nga fshati Aranitas i Mallakastrës, komisar i batalionit, bisedoi shtruar me popullin e Lopësit. Komisari buzagaz fliste ëmbël dhe i bëri për vete mjaft të rinj për të dalë vullnetarë partizan në mal. Qemali dëgjoi zërin e komisarit dhe zërin e zemrës e bashkë me shokët e fëmijërisë, Servetin dhe Hamdiun, shkuan me partizanët, atë të diel, në ditën e verës, 14 mars 1944. Shkuan në Sinanaj të tre. Tek shkolla u paraqitëm te përgjegjësi partizan, i cili i regjistroi partizanë. Qemali u caktua në k3b4p i BrVS, partizan me një maliher të gjatë italian, që e hiqte osh, se i vinte deri te këmbët, për ditë të tëra derisa u gjet një patickë. Po ku dinte Qemali paso parullën “Stalini-Sigurimi”?!. Ku kishte dëgjuar ndonjëherë fjalët parullë, Stalin e sigurim. Nuk e kuptoi fjalën “paso” e pyeti shokun, ç’farë thua?

Në Memorial mbërriti vëllai, Reizi, me ca ndërresa dhe bukë. I kërkoi të kthej në shtëpi se ishte i vogël. Qemali për disa orë ishte bërë burrë, nuk pranoi të shkëputej nga shokët. “Vëlla, - i tha, - ti sapo u martove, të kemi zot shtëpie, e unë punët e shtëpisë nuk i përballoj dot”. Në luftën partizane nga lartësitë e Shishtavecit, ku brigada përgatitej të kalonte në Kosovë, Qemalin e bënë përgjegjës rinie në b3p. Luftoi në Kosovë Qemali dhe fitoi. U kthye në Mamuginaj pas një rruge të gjatë. Tek dera e shtëpisë dëgjoi zërin e ëmbël të nënës: - Kush je ti, djal-o?, - Qemali i përgjigjet: - Jam një partizan. - Mirë a të keqen nëna, hajde bujrum, - i tha nëna dhe vazhdoi t'i frynte zjarrit... Qemali i tha: - Dede, jam Qemali! Nëna si nënë, hapi krahët si të shqiponjës dhe u përqaftua me mall e ngashërim... Rruga në jetë është më e gjatë sesa e mendojmë dhe kur i ke dalë në fund, ajo duket prapë e shkurtër.

Mesazhe për marinën

Qemal Hysaj ka mbyllur rrugëtimin rreth paralelit më të madh tokësor, duke na lënë trashëgimi librin jetësor, dëshmi historike. Mbas ‘lundrimit’ mes ‘yjësive’ u pozicionuat aty, ku theksoje vazhdimisht, ‘te konstelacioni’ më i bukur për marinarët, ‘Arusha e Vogël’, se aty gjendet ylli më i ndritshëm i kësaj yjësie, i cili ndihmon marinarët në çdo situatë të vështirë, e që quhet ‘Ylli Polar’. U bashkuat me të për të na ndriçuar ne, që vazhdojmë të ndjekim udhën tuaj në Tokë e në dete.

Marinarët shqiptarë janë krenarë për traditat, ritualet dhe zhargonin, madje, edhe për gabimet e tyre. Ata janë krenarë për ‘Flamurin Kombëtar dhe Flotës tonë Luftarake’, mbi të cilët u betuan dhe me dashuri të pafund do t’ua tregojmë brezave të rinj. Këto vlerat që Komandant Qemali i përcolli, marinarët janë mirënjohës për jetë! Ai u tregoi gjithmonë rrugën e duhur për hir të dashurisë së tij për Marinën.



17 nëntor 1944, ngjarje historike, vlerë patriotike, identitet kombëtar

17 nëntori shënon 78-vjetorin e çlirimit të Tiranës nga ushtria gjermane, në vitin 1944.

Lufta për çlirimin e Tiranës ishte operacioni më i madh i shkallës operative-strategjike i zhvilluar nga UNÇSH-ja për çlirimin e qyteteve.

Forcat e Brigadave që luftonin në kryeqytet i vazhduan pandërprerë sulmet e tyre për asgjësimin e armikut të rrethuar dhe në mëngjesin e 16 nëntorit u hodhën në sulmin përfundimtar për çlirimin e Tiranës.

Si rrjedhojë forcat e Brigadës I pushtuan Shtëpinë e Oficerëve, Sahatin, Teatrin, etj.

Forcat e Brigadës VIII përparuan në rrugën e Kavajës dhe morën takim me krahun e djathtë të Brigadës I, duke e ngushtuar edhe më shumë unazën e rrethimit të armikut në qendër të kryeqytetit.

Armiku qëndronte me egërsi në ndërtesat e ministrive, te Banka, Bashkia dhe në zonën ku aktualisht ndodhet Muzeu Historik Kombëtar. Luftimet vijuan shumë të ashpra gjatë gjithë ditës.

Natën, duke u gdhirë 17 nëntori, komanda gjermane nuk shikonte asnjë mundësi shpëtimi.

Ndërkohë që ishin krijuar të gjitha kushtet për të asgjësuar ose për të kapur rob këto forca. Gjermanët, duke përfutur nga errësira e natës, dolën nga rrethimi dhe u grumbulluan në fushën e Aviacionit.

Që këtej, pasi u organizuan për marshim, lëvizën drejt Vorës për në Shkodër. Forcat e fundit gjermane që u tërhoqën nga Tirana u goditën në rrugën Tiranë - Vorë - Laç.

Në mëngjesin e 17 nëntorit të vitit 1944, pas 19 ditë e net luftë të ashpër e të pandërprerë, kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, u çlirua.

Operacioni mësymës për çlirimin e Tiranës u përgatit dhe u zhvillua në kuadrin e mësymjes së përgjithshme të UNÇSH-së për çlirimin e plotë të



Shqipërisë.

Çlirimi i kryeqytetit pati rëndësi të madhe politike e ushtarake. Ai kurorëzoi fitoren e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; i shkaktoi humbje të mëdha dhe vonoi tërheqjen e forcave gjermane.

Etapat që çuan Tiranën drejt fitores mbi pushtuesin

Çlirimi i kryeqytetit është një datë e pakundërshtueshme dhe shumë përmbledhëse, por më shumë se kaq, tepër e nderuar për shqiptarët.

Nga dokumentet e ndryshme del

se që nga fundi i muajit gusht, ushtria gjermane kishte nisur ta fortifikonte Tiranën. Jo më kot, disa pjesë të qytetit ishin mbyllur krejtësisht dhe ishte përcaktuar një zonë e gjerë siguri në qendër të së cilës gjendej misioni gjerman.

7 shtator 1944, sinjalin e parë të ndryshimeve e dha prefekti i Tiranës, Qazim Mulleti, i cili u largua nga Shqipëria për në Gjermani. Para këtij fakti, autoritetet ushtarake gjermane propozuan që posti i kryetarit të bashkisë dhe prefektit të shkriheshin në një të vetëm. Propozimi u hodh poshtë. Për Tiranën u krijua një komitet i kontrolluar prej tre vetash, që shumë shpejt u shpërbë.

15 tetor, përfaqësia gjermane në Tiranë u shpërnda, ndërkohë që qyteti mbeti pa një autoritet shqiptar të efektshëm dhe filloi një situatë shumë kaotike.

26 tetor, ngjarjet nuk

hodhën 28 avionë raketa-lëshues, të cilat i shkaktuan dëm të madh kazermove të fortifikuara që kishin ndërtuar gjermanët.

11 nëntor, filloi faza e dytë dhe vendimtare e betejës, ku partizanët ndërmorën një sulm të ri ndërkohë që nga Jugu po afrohej një autokolonë përforcuese gjermane.

13-15 nëntor, kjo autokolonë me njësi të Korparmatës XXII që vinin nga drejtimi Strugë-Elbasan dhe përbëhej nga 2000 - 3000 trupa u sulmua në afërsi të Qafë - Kërrabës nga njësitë e Brigadës I dhe VIII. Ndërkohë që burime gjermane pohojnë se ajo u shpëtua nga një numër i vogël tankesh që u dërguan nga Tirana. 17 nëntor, garnizonet gjermane u evakuuan përfundimisht nga Tirana, duke vazhduar rrugën drejt Shkodrës nëpërmjet rrugës bregdetare që shkonte drejt Shkodrës.

Humbjet gjatë betejës

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e qytetit të Tiranës dhe rrethinave të saj, ranë 127 partizanë. Për çlirimin e Tiranës luftuan Njësitë partizane dhe Njësitë guerilase të organizuar në nëntë çeta luftarake.

Dokumentet gjermane nuk japin shifra rreth numrit të të vrarëve apo të plagosurve gjatë betejës së Tiranës. Sipas historiografisë shqiptare gjatë



mund të vazhdonin më ndryshe dhe Këshilli i Lartë i Regjencës dhe Qeveria kolaboracioniste e Biçakut dhanë dorëheqjen.

Mehmet Shehu përgatiti planin e sulmit. Faza e parë e betejës filloi kur forcat partizane sulmuan nga jugu me rreth dymijë luftëtarë, të mbështetur nga artileria dhe autobлиндat.

Gjermanët u tërhoqën në pozicione të parapërgatitura në Tiranën e Re, duke ua lënë pjesën e vjetër të qytetit partizanëve. 29 tetor, divizioni I i Mehmet Shehut, i përbërë nga Brigada I, IV dhe XXIII ndërmerr një sulm të përgjithshëm mbi qytetin e Tiranës. Brenda një dite forcat ajrore britanike që bashkëpunuan me forcat partizane

kësaj beteje u vranë 2 000 gjermanë dhe u zunë rob 500 të tjerë.

Dëmet më të rënda janë regjistruar në pikat e fortifikuara ku gjermanët kishin vendosur trupa por me përjashtim të ciflosjeve nga plumbat e armëve duket se qyteti nuk pësoi ndonjë dëm të madh. Çlirimi i Tiranës ishte një kontribut i rëndësishëm për të forcuar legjitimitetin dhe besueshmërinë e Shqipërisë, si një vend i përkushtuar në Aleancën Antifashiste. Mesazhet e mëdha të lirisë, paqes dhe luftës kundër tiranisë, tingëllojnë edhe sot më aktuale se kurrë, të nderuara dhe të pacenuara nga koha dhe devijimet e mëvonshme të kauzës së lirisë të partizanëve tanë të lavdishëm.



Mundësi të *shkëlqyera* studimi në *akademitë ushtarake* më të mira në botë.
Tetë bursa të plota studimi, **6** në Akademinë e Marinës në SHBA dhe 2 në Itali, njëra për karabinieri në Modena, tjetra për detari në Livorno.


Gjithçka mbulohet nga shtetet pritëse.

Forcat e Armatosura shqiptare garantojnë *punësim dhe karrierë të sigurt* pas përfundimit të studimeve.

Kriteret dhe afatet i gjeni në linqet e mëposhtme:

<https://bit.ly/3SIJ2Vd>

<https://bit.ly/3FqoyxI>



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

8 BURSA STUDIMI



NË AKADEMITË
USHTARAKE MË TË
MIRA NË BOTË